

Integrimi i qasjeve transformuese gjinore në edukimin në fëmijërinë e hershme, kurrikula dhe pedagogji



Përmbajtja

Hyrje	3
Praktikat më të mira.....	3
Planifikimi dhe buxhetimi	4
Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës	6
Zhvillimi i fuqisë punëtore	8
Angazhimi i familjes dhe komunitetit.....	9
Sigurimi i cilësisë.....	11
Gjetjet.....	12
Ligjet dhe mekanizmat ndërkombëtarë	12
Legjislacioni, politikat dhe strategjitë e Kosovës.....	13
Mbledhja dhe raportimi i të dhënave institucionale.....	18
Standardet e EFH, tekstet shkollore, materialet e mësimi dhe udhëzime të tjera	18
Shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme, regjistrimi dhe stafi.....	20
Përfundim	22
Rekomandimet.....	24
Planifikimi dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	24
Kurrikula dhe zbatimi	26
Fuqia punëtore	26
Angazhimi i familjes dhe komunitetit.....	27
Sigurimi i cilësisë.....	27
Burimet e cituara.....	29
Anekset.....	31
Grafiku 1. Numri i institucioneve publike dhe private të arsimit të hershëm dhe parashkollor (sipas komunës).....	31
Grafiku 2. Regjistrimi në institucionet publike dhe private të arsimit të hershëm në vitin 2022/23 (sipas gjinisë).....	32
Tabela 1. Vajzat dhe djemtë që ndjekin arsimin e hershëm (0-6) në Kosovë (sipas përkatësisë etnike)	32
Grafiku 3. Fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin institucionet publike të arsimit të hershëm (0-6)	33
Grafiku 4. Vajzat dhe djemtë që ndjekin qendrat burimore të arsimit të hershëm	33
Grafiku 5. Statusi social dhe familjar i vajzave dhe djemve që ndjekin arsimin e hershëm dhe parashkollor (0-6)	34

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2024

Ky dokument u përgatit nga Sara Nicole Baxley për Rrjetin e Grave të Kosovës me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Pikëpamjet e shprehura këtu i përkasin autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e ADA.

Hyrje

Hulumtimet vënë në pah se regjistrimi i vajzave dhe djemve në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) shoqërohet me sukses më të madh në arsimin fillor¹ si dhe me fuqizimin ekonomik të grave.² Studimet globale sugjerojnë se edukimi i hershëm mund të ndihmojë në transformimin e roleve dhe normave tradicionale gjinore, duke i mësuar fëmijët që në moshë të re se ata kanë mundësi të barabarta për profesione dhe zgjedhje të ndryshme në jetë, pavarësisht nga gjinia e tyre. Plani i Veprimit Gjinator i BE-së (PVGj) III, Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Objektivat e BE-së në Barcelonë theksojnë rëndësinë e trajtimit të normave, roleve dhe marrëdhënieve tradicionale gjinore përmes edukimit në të gjitha nivelet, në kurrikula dhe praktika mësimore, për të transformuar qëndrueshëm rolet dhe marrëdhëniet e socializuara që kontribuojnë në pabarazitë gjinore.

Korniza ligjore e Kosovës e përmend në mënyrë të qartë barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi si objektiva kyçe. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka prioritet EFH si një objektiv strategjik dhe është e angazhuar në planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës EFH,³ sigurimin e objekteve, vendosjen e standardeve,⁴ dhe bërjen e arsimit parafillor të detyrueshëm për vajzat dhe djemtë e moshës 5-6 vjeçare.⁵ Prandaj, është koha e duhur për të shqyrtuar (dhe për të mësuar nga) praktikatat më të mira ndërkombëtare për transformimin e normave tradicionale gjinore dhe për avancimin e barazisë gjinore në EFH. Ky dokument politikash synon të kontribuojë në integrimin e praktikave më të mira transformuese gjinore të EFH brenda institucioneve, politikave, kurrikulave dhe praktikave pedagogjike përkatëse, me qëllim që të kontribuojë në fuqizimin ekonomik të grave, barazinë gjinore dhe transformimin e normave tradicionale dhe/ose diskriminuese gjinore në Kosovë.

Praktikat më të mira

Praktikat më të mira ndërkombëtare njohin domosdoshmërinë e integritit të qasjeve arsimore transformuese gjinore në fusha të shumta. Përqendrimi vetëm në politika ose programe mësimore mund të mos transformojë në mënyrë efektive normat diskriminuese gjinore. Praktikatat më të mira kërkojnë zgjidhje transformuese gjinore të koordinuara në politika të EFH, kurrikula, infrastrukturë, mekanizma organizativë, shërbime, trajnimin e mësuesve dhe stafit, si dhe në pedagogji. Si të tilla, të gjitha institucionet përkatëse duhet të aplikojnë dhe integrojnë qasjet transformuese gjinore në legjislacion, politika, skema sociale dhe mekanizma të sigurimit të cilësisë; në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë trajnimin para fillimit të punës dhe gjatë punës; si dhe në kurrikula dhe pedagogji. Më tej, rekomandimet specifike për zbatimin e këtyre kurrikulave duhet të përgjigjen ndaj aftësive zhvillimore të bazuara në fakte të vajzave dhe djemve, situatave dhe nevojave të ndryshme të vajzave dhe djemve, grave

¹ Përkufizime të ndryshme për EFH-n, arsimin parashkollor dhe parashkollor përdoren në Kosovë dhe globalisht. Në këtë përmblendje politikash, EFH i referohet arsimit të hershëm për vajzat dhe djemtë nga moshë 0 deri në 6 vjeç. Termi 'parashkollor' i referohet moshave nga 0 deri në 5 vjeç, ndërsa 'parafillor' i referohet moshave nga 5 deri në 6 vjeç.

² Komisioni Evropian (KE), *Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth* [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse], 2013, f. 4. Kohët e fundit, KE ka rritur objektivat e Barcelonës për fëmijët e regjistruar në EFH. Objektivat e rishikuara për regjistrimin në EFH deri në vitin 2030 janë 45% për fëmijët më të vegjël se tre vjeç dhe 96% për fëmijët ndërmjet moshës tre vjeç dhe arsimit fillor të detyrueshëm. Shih Këshilli i Bashkimit Evropian, *Council Recommendation on early childhood education and care: Barcelona targets for 2030* [Rekomandimi i Këshillit për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme: objektivat e Barcelonës për vitin 2030]. Për një studim specifik për Kosovën, shih RrGK, *Kush kujdeset?*, 2016, f. 8.


³ Kryeministri, *Komisioni për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme*.

⁴ Udhëzimi Administrativ nr. 03/2022 për *Përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore*.

⁵ Ligji nr. 08/L-153 për *Edukimin në Fëmijërinë e Hershme*.

dhe burrave, si dhe nevojave të tyre të ndryshme ndërthurëse⁶ dhe nevojave të komuniteteve.⁷ Bazuar në një numër rastesh studimore globale, Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Emergjencën e Fëmijëve (UNICEF) ka identifikuar praktikat më të mira që aplikojnë një qasje gjithëpërfshirëse transformuese gjinore në pesë fusha: 1. planifikimi dhe buxhetimi, 2. zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës, 3. zhvillimi i fuqisë punëtore, 4. angazhimi i familjes dhe komunitetit dhe 5. sigurimi i cilësisë (shih Figurën 1).⁸ Në këtë dokument shqyrtohet secila prej këtyre fushave.

Figura 1. Praktikrat më të mira të UNICEF-it në fushën e EFH transformues gjinor



Planifikimi dhe buxhetimi

Planifikimi dhe buxhetimi kërkon avokim të koordinuar, ndërgjegjës, hartim dhe zbatim të politikave, trajnim, monitorim dhe vlerësim.⁹ Praktikrat më të mira theksojnë rëndësinë e planifikimit, buxhetimit dhe menaxhimit holistik të burimeve njerëzore dhe fizike të EFH, në mënyrë institucionale, me shumë palë dhe të bazuar në dëshmi. Në planifikim, një analizë gjinore që angazhon palët e interesuara, shoqërinë civile dhe ekspertët është thelbësore për të vlerësuar se deri në çfarë mase legjislacioni, politikat dhe mekanizmat janë të përgjegjshëm ndaj aspektit gjinor. Analizat gjinore duhet të identifikojnë situatat ndërthurëse që veprojnë si pengesa për regjistrimin e vajzave dhe djemve të ndryshëm në EFH, siç janë vendbanimi i fëmijëve (urban dhe rural); situatat familjare (nevojat e veçanta të fëmijëve, mjetet ekonomike, kujdestari i vetëm, arsimimi i kujdestarëve dhe kujdestareve, përkatësia

⁶ Në këtë dokument, termi 'ndërthurës' i referohet përvajave të ndërlidhura në shoqëri, siç janë mënyrat në të cilat aspekt gjinor ndërthuret me faktorë të tjerë për të ndikuar në qasjen dhe të drejtat, për shembull, përkatësia etnike, feja, gjuha, aftësitë e kufizuara, mosha, statusi socio-ekonomik, vendndodhja gjeografike (rurale dhe urbane), si dhe situatat e jetesës së kujdestarit të vetëm dhe vajzat dhe djemtë pa prindër.

⁷ UNICEF, *Build to Last, A Framework in Support of Universal Quality Pre-primary Education* [Qëndrueshmëri afatgjate, një kornizë në mbështetje të arsimit parafillor cilësor dhe universal], 2020.

⁸ UNICEF, *Tackling Gender Inequality From the Early Years* [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

⁹ Po aty.

etnike, gjuha, etj.); dhe ndërgjegjësimi i kujdestarëve për përfitimet e EFH.¹⁰ Gjetjet nga këto analiza duhet të pasqyrohen në objektivat dhe treguesit e Planit të Sektorit të Arsimit, ose Planit Strategjik Arsimor dhe Planit të Veprimit (në rastin e Kosovës).

Figura 2. Analiza gjinore ndërsektoriale duhet të informojë planifikimin dhe buxhetimin arsimor




Në varësi të vendit ku jetojnë fëmijët, ata mund të përballen me pengesa shtesë për të ndjekur shkollën; fëmijët në zonat rurale mund të kenë vështirësi në qasjen në transport dhe sigurimin e një udhëtimi të sigurt, veçanërisht vajzat. Fëmijët me aftësi të kufizuara mund të përballen me sfida të shtuara të qasshmërisë. Situata ekonomike e fëmijëve mund të ndikojë në qasjen e tyre. Prandaj, është e nevojshëm një qasje ndërsektoriale e ndjeshme ndaj gjinisë për të adresuar këto sfida.

Legjislacioni që siguron qasje në arsim për vajzat dhe djemtë, si dhe parandalon diskriminimin në bazë të gjinisë, aftësisë dhe situatës familjare, kontribuon në regjistrimin e vajzave dhe djemve në EFH.

Në mënyrë të ngjashme, politikat dhe mekanizmat që monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e legjislacionit sigurojnë mundësi më gjithëpërfshirëse për të mësuar në EFH për vajza dhe djem të ndryshëm. Politikat duhet të shqyrtojnë se si të përfshijnë qasje të qarta të përgjegjshme dhe transformuese gjinore në trajnimin e mësimitdhënësve, certifikimin minimal dhe standardet e cilësisë së shërbimeve.¹¹ Po ashtu, politikat duhet të përcaktojnë kërkesat organizative si standardet operative dhe të Kodit të Sjelljes për ofruesit dhe stafin të EFH.¹² Së fundi, politikat duhet të parashikojnë strategji për rritjen e angazhimit të komunitetit dhe prindërve që të rrisin ndërgjegjësimin për përfitimet e EFH transformues gjinor.

Së fundi, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është i nevojshëm për të transformuar normat gjinore dhe për të kontribuar në barazinë gjinore. Për shembull, Iniciativa e Kombeve të Bashkuara për Arsimin e Vajzave, një instrument për menaxhimin e përgjegjshëm gjinor të shpenzimeve publike, integron aspektin gjinor në katër faza të ciklit buxhetor: (1) përgatitja, (2) miratimi, (3) ekzekutimi dhe (4)

Figura 3: Menaxhimi i shpenzimeve publike me përgjegjësi gjinore: Integrimi i vëmendjes ndaj gjinisë gjatë gjithë ciklit buxhetor



¹⁰ UNICEF, *ECE Accelerator Toolkit*, 2020; UNICEF, *Tackling Gender Inequality from the Early Years* [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

¹¹ UNICEF, *ECE Accelerator Toolkit*, 2020.

¹² Po aty.

mbikëqyrja.¹³ Politikat duhet të kërkojnë që buxhetet për arsimin të përfshijnë situatat dhe nevojat e ndryshme ndërthurëse të vajzave, djemve, grave dhe burrave të ndryshëm. Sa i përket BPGj-së, planifikimi dhe buxhetimi i sektorit arsimor duhet të angazhojnë prindërit, mësuesit dhe stafin.¹⁴

Rritja e financimit publik që e bën EFH-në më të qasshme dhe të përballeshme është e lidhur me pjesëmarrjen më aktive të grave në tregun e punës.¹⁵ Për të qenë e qasshme, EFH duhet të ketë një numër të mjaftueshëm objektesh përkujdesjeje që janë të vendosura në mënyrë të përshtatshme dhe ofrojnë shërbime për fëmijët gjatë orarit të punës së kujdestarëve. Po ashtu, kostot e EFH-së duhet të pasqyrojnë situatën ekonomike të komunitetit. Studimet globale tregojnë se të ardhurat më të ulëta të familjes dhe kostoja e lartë e EFH-së janë barriera kryesore që EFH të jetë gjithëpërfshirës.¹⁶ Prandaj, Objektivat e Barcelonës e shohin si më të nevojshmet për shërbime EFH të përballeshme dhe të qasshme shtëpitë e kujdesit për kujdestarët e vetëm dhe familjet me të ardhura më të ulëta.¹⁷ Vendet që kanë arritur objektivat e vendosura më parë të Barcelonës kanë investuar në infrastrukturën e EFH-së, kanë ofruar kupona dhe/ose subvencione për EFH-në dhe, në disa raste, kanë ofruar EFH falas.¹⁸

“

Për të qenë arsimit i hershëm i qasshëm, duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të institucioneve të kujdesit që janë të vendosura në mënyrë të përshtatshme dhe shërbime të tjera të kujdesit gjatë orëve të punës së kujdestarëve.

”

Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulës

Praktikat më të mira për kurrikulat EFH identifikojnë mundësitë e të mësuarit të bazuar në lojë, të cilat përfshijnë objektiva që janë të



Figura 4: Kurrikulat mund të sfidojnë stereotipet gjinore.

¹³ Iniciativa e Kombeve të Bashkuara për Edukimin e Vajzave, [Spending Better for Gender Equality in Education](#) [Përdorim më efektiv i buxhetit për barazi gjinore në arsim], 2021.

¹⁴ VVOB dhe FAWE, [Gender-Responsive Pedagogy in Early Childhood Education a Toolkit for Teachers and School Leader](#), [Pedagogjia e përgjegjshme gjinore në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme: Udhëzues për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave] VVOB, Bruksel, 2019.

¹⁵ UNICEF, [Tackling Gender Inequality From the Early Years](#) [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

¹⁶ EC, [Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth](#) [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse] 2013.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Në të kaluarën, Objektivat e Barcelonës kërkonin që 90% e vajzave dhe djemve të ishin të regjistruar ndërmjet moshës tre vjeç dhe moshës së shkollës fillore të detyrueshme, dhe 33% për vajzat dhe djemtë më të vegjël se tre vjeç (KE, [Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth](#) [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse] 2013). Objektivat e rishikuara tani synojnë një shkallë regjistrimi prej 96% për vajzat dhe djemtë midis moshës tre vjeç dhe moshës së shkollës fillore të detyrueshme, dhe 45% për ata më të vegjël se tre vjeç (shih Këshilli i Bashkimit Evropian, [Council Recommendation on early childhood education and care: Barcelona targets for 2030](#) [Rekomandimi i Këshillit mbi Edukimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme: Objektivat e Barcelonës për vitin 2030]).

përgjegjshëm gjinor me udhëzime të qarta dhe shembuj të praktikave organizative dhe pedagogjike transformuese gjinore si elemente thelbësore. Kurrikulat e tilla përshkruajnë parimet dhe qasjet pedagogjike për arritjen e rezultateve të të nxënit; përfshijnë materiale të sugjeruara mësimore; përshkruajnë qartë kompetencat operative dhe ato të fuqisë punëtore; dhe identifikojnë strategji për të siguruar që “kurrikula e fshehur”¹⁹ të mos përforcojë stereotipe dhe norma diskriminuese gjinore.

Praktikat më të mira kërkojnë që palët e interesuara, edukatorët dhe politikëbërësit të punojnë së bashku për të identifikuar dhe vlerësuar stereotipet diskriminuese gjinore në materialet mësimore dhe për të përfshirë materiale mësimore më neutrale ndaj aspektit gjinor, të bazuara në lojë. Kjo përfshin libra shkollorë, libra, video dhe lodra. Analizat gjinore të materialeve mësimore mund të vlerësojnë sa shpesh përfaqësohen vajzat, djemtë, gratë dhe burrat, rolet që ata luajnë dhe diversitetin e përfaqësimit të vajzave, djemve, grave dhe burrave në këto materiale (p.sh., racat, etnitë, aftësitë, moshat).²⁰

Figura 5: Mësuesit mund t'u japin fëmijëve lodra që sfidojnë stereotipet gjinore.



Së fundi, praktikat më të mira përpiqen të bëjnë “kurrikulën e fshehur” më transformuese gjinore. Kjo kërkon që institucionet dhe ofruesit e EFH të angazhojnë botuesit në zhvillimin e teksteve dhe librave transformues gjinor; dhe të angazhojnë mësuesit dhe stafin në aktivitete që ofrojnë mundësi për të reflektuar mbi paragjykimet e tyre gjinore, zakonet dhe ndërveprimet me fëmijët dhe prindërit. Kurrikulat transformuese gjinore ofrojnë mjete për mësuesit dhe stafin për të adoptuar qasje mësimore dhe administrative që plotësojnë standardet e cilësisë transformuese gjinore. Standarde të tilla, natyrisht, duhet të përcaktohen qartë në legjislacion, politika, kurrikula dhe mekanizma të tjerë. Legjislacioni dhe politikat duhet të parashikojnë përditësimin dhe sigurimin e trajnimit para fillimit dhe gjatë punës (me afate reale kohore dhe mundësi trajnimi në punë) për të mbështetur mësuesit dhe stafin në zhvillimin e kompetencave të mësimdhënies transformuese gjinore. Mundësitë e trajnimit transformues gjinor duhet gjithashtu të sigurohen në buxhetimin arsimor të përgjegjshëm gjinor.²¹

¹⁹ Kurrikula e fshehur përkufizohet si transmetimi joformal i normave në mjedisin mësimor, jashtë kurrikulës formale (UNICEF, [Tackling Gender Inequality From the Early Years](#) [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022). Kurrikula e fshehur mund të përcjellë norma gjinore përmes materialeve të mësimit, fotografive, paragjytimeve të mësuesve, dhe ndërveprimeve të mësuesve dhe stafit me vajzat dhe djemtë.

²⁰ Po aty.

²¹ UNICEF, [Tackling Gender Inequality From the Early Years](#) [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

Zhvillimi i fuqisë punëtore

Zhvillimi i fuqisë punëtore përfshin strategjitë e punësimit të stafit dhe edukatorëve që synojnë barazi më të madhe gjinore në nivelin EFH, zhvillimin profesional dhe planet e ruajtjes së stafit; standardet dhe trajnime të kompetencave profesionale; dhe mbështetje për sigurimin e mundësive të të mësuarit për vajzat dhe djemtë e moshës parashkollore.²²

Punësimi i përgjegjshëm gjinor i edukatorëve të EFH synon për barazi më të madhe gjinore mes mësuesve të EFH. Për të punësuar më shumë burra edukatorë EFH, praktikatat më të mira sugjerojnë profesionalizimin e sektorit, rritjen e pagave, ofrimin e rrugëve alternative të karrierës (p.sh., aplikimi i kredisë universitare për përvojat e mëparshme) dhe fushata ndërgjegjësimi që luftojnë stereotipet diskriminuese ndaj kujdestarëve burra dhe promovojnë burrat si kujdestarë kompetentë.²³

Figura 6: Profesionalizimi i sektorit, rritja e pagave, ofrimi i mundësive alternative të karrierës dhe fushatat e ndërgjegjësimit mund të inkurajojnë më shumë burra të punojnë në arsimin e hershëm.



Përveç rritjes së barazisë gjinore mes profesionistëve të EFH, strategjitë e ruajtjes së stafit janë të rëndësishme. Për të mbështetur mbajtjen e mësuesve të EFH, stafi mësimor ka nevojë për trajnime në zbatimin e qasjeve transformuese gjinore. Trajnimi cilësor para fillimit të punës dhe gjatë punës gjithashtu mund të kontribuojë në mbajtjen e mësuesve, pasi mësuesit janë më të aftë për të përmbushur standardet. Mbajtja e stafit gjithashtu kërkon që standardet organizative të sigurojnë kushte të mira pune dhe mbështetje të mjaftueshme për mësuesit. Shembuj të praktikave më të mira në standardet operacionale mund të përfshijnë: raportin e ulët fëmijë-mësues, mundësi zhvillimi profesional që mësojnë strategjitë pedagogjike transformuese gjinore, paga konkurruese dhe mundësi ngritje në pozitë, si dhe staf mbështetës të nevojshëm, veçanërisht për fëmijët me nevoja të ndryshme mësimore.²⁴

Për të siguruar kualifikimet e mësuesve dhe stafit, standardet dhe strategjitë e cilësisë duhet të përcaktohen qartë në politikat me linja buxhetore specifike për trajnim. Praktikatat më të mira njohin rëndësinë e mundësive të trajnimit para dhe gjatë punës. Trajnimi para punës duhet të përfshijë strategji për rekrutimin e më shumë edukatorëve burra dhe për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e mësuesve të EFH-së burra. Trajnimi gjatë punës duhet të integrojë strategji për fuqizimin e mësuesve

²² Po aty.

²³ Po aty. Qeveria daneze dhe ajo suedeze kanë regjistruar rritje të vogla pozitive në barazinë gjinore të mësuesve dhe stafit të EFH duke integruar masa të përgjegjshme gjinore në politikat arsimore (KE, [Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth](#) [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse]2013; OBZHE, [Starting Strong 2017: Key OECD Indicators on Early Childhood Education and Care](#) [Fillim i fuqishëm: Treguesit Kryesorë të OBZHE mbi Edukimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme], OECD Publishing, Paris, 2017; UNESCO, [Education Starts Early](#) [Edukimi fillon herët], 2022.

²⁴ UNICEF, [Tackling Gender Inequality from the Early Years](#) [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

ekzistues të EFH me standarde të përditësuara për një periudhë të arsyeshme kohore dhe në module trajnimi të përshtatshme (p.sh., modulet e trajnimit të fundjavës ose trajnime online). Kostoja e zhvillimit profesional duhet të pasqyrojë mjetet e profesionistëve të EFH për të siguruar mbajtjen e ofruesve.²⁵ Për të mbështetur më mirë nevojat e ndryshme dhe ndërthurëse të vajzave dhe djemve, trajnimi i mësuesve

Figura 7: SQI: Standardet operacionale mund të inkurajojnë mbajtjen e mësuesve të arsimit të hershëm.

duhet të përfshijë trajnimin në edukimin special për mësuesit dhe mësuesit ndihmës të EFH.

Angazhimi i familjes dhe komunitetit



Shërbimet EFH të qasshme dhe të përballueshme janë thelbësore për angazhimin e komuniteteve. Praktikrat më të mira përfshijnë qeverinë dhe investitorët privatë në ndërtimin e infrastrukturës në vendndodhje të përshtatshme në komunitete; stimuj për ofrimin e qendrave ditore për kujdesin ndaj fëmijëve dhe qendrave EFH; sigurimin e transportit për vajzat dhe djemtë e regjistruar në qendra;²⁶ dhe marrjen parasysh të situatave të ndryshme të grave dhe burrave. Kjo përfshin shqyrtimin e mënyrës se si gratë dhe burrat në situata të ndryshme socio-ekonomike organizojnë transportin e fëmijëve të tyre, gjë që mund të ndikojë në gjetjen e vendndodhjes së objektit. Infrastruktura duhet të përgjigjet ndaj vlerave dhe nevojave kulturore të ndryshme dhe të ndërthurura të komuniteteve. Së fundi, objektet dhe shërbimet duhet të sigurojnë përmbushjen e nevojave të ndryshme njohëse dhe fizike të vajzave dhe djemve.

Figura 8. Investimet në infrastrukturë mund të lehtësojnë qasjen në shërbimet e përballueshme të arsimit të hershëm



²⁵ Po aty.

²⁶ KE, *Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth* [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse], 2013.

Qasshmëria gjithashtu përfshin mënyrën se si orët e funksionimit dhe kostoja e shërbimeve EFH i përgjigjen nevojave të kujdestarëve parësorë në komunitet.²⁷ Orët kur ofrohet kujdesi duhet të pasqyrojnë orët e punës së kujdestarëve parësorë, duke përfshirë kujdesin e zgatur si për shembull, mbërritjet e hershme dhe kujdesin pas shkollës, ushqimet me vlera ushqyese dhe të përshtatshme nga aspekti kulturor (mëngjesi, dreka dhe zamra), dhe shërbime gjatë gjithë vitit.²⁸

Investimet e qeverisë në infrastrukturë kontribuojnë në uljen e kostove të EFH. Megjithatë, vetëm investimi në infrastrukturë mund të mos e bëjë EFH të përballeshme për të gjitha familjet. Për ta

bërë EFH të përballeshme për të gjitha vajzat dhe djemtë duhet të merren parasysh situata të ndryshme socio-ekonomike. Kostoja e shërbimeve nuk duhet të tejkalojë potencialin e fitimit nga kujdestari parësor. Shembuj për rritjen e kostos së EFH për të gjitha familjet përfshijnë EFH falas, subvencione nga qeveria dhe/ose stimuj privatë.²⁹ Pra, shërbimet EFH duhet të



Kostoja e shërbimeve nuk duhet të tejkalojë potencialin e të ardhurave të kujdestarit kryesor.



planifikohen dhe buxhetohen në përputhje me nevojat e ndryshme dhe ndërthurëse të komunitetit, me vëmendje të veçantë ndaj familjeve me të ardhura më të ulëta dhe familjeve me një kujdestar.³⁰

Studimet globale njohin rolin e vlerave dhe normave të familjes dhe të kujdestarëve në formësimin e normave gjinore të vajzave dhe djemve. Prandaj, ndërgjegjësimi i kujdestarëve për përfitimet e EFH dhe mënyrën se si ky edukim kontribuon në barazinë gjinore është i rëndësishëm. Meqenëse gratë kujdestare zakonisht janë më të angazhuara në arsim dhe kujdes, qendrat EFH me strategji për angazhimin e kujdestarëve si për gratë ashtu edhe për burrat kontribuojnë në krijimin e mjediseve mësimore më transformuese gjinore.³¹

Për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e EFH dhe përfshirjen e grave dhe burrave kujdestarë, gratë dhe burrat kujdestarë duhet të angazhohen në mënyrë më të barabartë në procesin e të mësuarit të vajzave e djemve, si dhe në promovimin e rëndësisë së transformimit të normave gjinore diskriminuese dhe stereotipike. Për shembull, politikat EFH mund të kërkojnë që mësuesit dhe stafi të kontaktojnë si nënën ashtu edhe babanë kur një fëmijë është i sëmure; të ofrojnë aktivitete që angazhojnë vetëm baballarët ose burrat kujdestarë; dhe të organizojnë ngjarje të tjera në komunitet që promovojnë ndërgjegjësimin për mënyrat se si normat sociale mund të kontribuojnë në mënyrë të pandërgjegjshme ndaj normave gjinore diskriminuese dhe/ose stereotipike.³²

²⁷ UNICEF, *Tackling Gender Inequality from the Early Years* [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

²⁸ Po aty.

²⁹ Për shembuj specifikë të Kosovës, shih: RrGK, *Kush kujdeset?*, 2016,

³⁰ KE, *Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth* [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse], 2013.

³¹ UNICEF, *Tackling Gender Inequality from the Early Years* [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

³² Po aty.

Figura 9: Politikat e arsimit të hershëm mund të inkurajojnë angazhimin e të dy prindërve, si për shembull duke kontaktuar si baballarët ashtu edhe nënat kur fëmija është i sëmurë.



Sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë (SC) përcakton dhe siguron cilësinë e shërbimeve EFH, si dhe ofron mundësi për përmirësimin e tyre. Si në planifikim ashtu edhe në buxhetim, SC paraqet një përpjekje gjithëpërfshirëse dhe strategjitë e mekanizmat e SC duhet të përdoren në të gjitha fushat e përmendura më sipër.³³ Për më tepër, SC dhe mbledhja e të dhënave duhet të lidhen me sistemet EFH për planifikim dhe buxhetim. Nevojitet një qasje me shumë palë për analizën gjinore (në nivel kombëtar, rajonal, parashkollor, trajnim formal dhe joformal, etj.) për të siguruar që të gjitha fushat janë vlerësuar dhe përshtatur me nevojat e identifikuar. Angazhimi i palëve të interesuara jo vetëm që ofron njohuri për fushat që kanë nevojë për përmirësime dhe investime, por gjithashtu rrit përgjegjshmërinë e këtyre palëve.³⁴

Praktikat më të mira përfshijnë politika që përcaktojnë standardet, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, si dhe strategjitë për zhvillimin dhe/ose përshtatjen e politikave përkatëse dhe buxhetimin sipas gjetjeve. Së paku, të dhënat duhet të ndahen sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë ndërthurës që prekin gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Praktikat më të mira integrojnë oraret dhe mjetet e inspektimit në politikat e SC. Megjithatë, vetëm të dhënat dhe politikat e sigurimit të cilësisë nuk janë të mjaftueshme për të siguruar që mjediset e të mësuarit dhe qasjet e mësimdhënies janë transformuese gjinore.

Strategjitë për SC duhet të përfshijnë mjete vlerësimi për ofruesit e shërbimeve EFH dhe komunitetet që vlerësojnë në mënyrë të qartë se deri në çfarë mase shërbimet EFH adresojnë stereotipet gjinore. Praktikat e tilla mund të vlerësojnë shkallën në të cilën mësuesit, të ndarë sipas gjinisë, kanë pasur trajnime për transformimin gjinor; numrin e mësuesve që zbatojnë pedagogjinë gjinore dhe transformuese; dhe përdorimin e gjuhës dhe ilustrimeve të ndjeshme gjinore.³⁵ Këto vlerësime mund të zbatohen në mënyra të ndryshme dhe të kombinojnë praktikat e monitorimit të jashtëm me anketat reflektuese të vetëvlerësimit. Shembuj të mjeteve për mbështetje të mjedisve mësimore më transformuese gjinore përfshijnë integrimin e treguesve transformues gjinorë në mjetet e monitorimit³⁶; manuale për vlerësimin e paragjykimëve gjinore në materialet mësimore; dhe mundësitë e vetëvlerësimit

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

³⁵ UNICEF, *Tackling Gender Inequality from the Early Years* [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

³⁶ Për shembuj të treguesve transformues gjinorë, shih: Banka botërore, *Teach ECE: Helping Countries Track and Improve Teaching Quality in Early Childhood Education* [Mësoni EFH: Ndihmë vendeve në gjetjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin e hershëm], 2021. RrGK ka zhvilluar gjithashtu modele për të vlerësuar nëse mjediset e të mësuarit dhe qasjet pedagogjike në shkollat e mesme të Kosovës janë transformuese gjinore. Shumë nga këta indikatorë mund të përshtaten për mjedisin mësimor EFH.

për mësuesit dhe stafin për të reflektuar mbi paragjykimet e tyre gjinore dhe ndikimin e këtyre në ndërveprimet e tyre pedagogjike dhe ndërpersonale me vajzat dhe djemtë.

Figura 10: Disa mjete mund të mbështesin mjediset mësimore transformuese gjinore.



Gjetjet

Gjetjet në këtë seksion janë nxjerrë nga një rishikim i legjislacionit, politikave, mekanizmave dhe të dhënave dhe raporteve që janë në dispozicion nga institucionet publike, ndërkombëtare dhe vendore të Kosovës.

Ligjet dhe mekanizmat ndërkombëtarë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e bën të zbatueshme në Kosovë Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe CEDAW.³⁷ Edhe pse qasja në EFH falas nuk përmendet në mënyrë eksplicite në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, e drejta për arsim është e garantuar, pa diskriminim në bazë të gjinisë dhe përkatësisë etnike; për më tepër, arsimi duhet të jetë i qasshëm për vajzat dhe djemtë me aftësi të kufizuara.³⁸ Nenet 28 dhe 29 përmendin shprehimisht të drejtën për arsim cilësor që kontribuon në respektimin e të drejtave të njeriut; dhe arsimi që kontribuon në kuptimin e barazisë gjinore përmendet shprehimisht në nenin 29.³⁹

Në mënyrë të ngjashme, neni 5 i CEDAW kërkon që shtetet të luftojnë në mënyrë aktive stereotipet dhe rolet gjinore të dëmshme ose diskriminuese.⁴⁰ Neni 10 kërkon që shtetet të luftojnë stereotipet gjinore përmes ofrimit të mundësive të barabarta për arsim në të gjitha nivelet dhe duke siguruar që tekstet shkollore, programet shkollore dhe metodat e mësimdhënies të mos përforcojnë stereotipe të dëmshme gjinore ose role gjinore.⁴¹ OZHQ-të gjithashtu përmendin barazinë gjinore në kontekstin e arsimit. OZHQ 4⁴² i jep përparësi arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, ndërsa

³⁷ Neni 22, [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#), 15 qershor 2008.

³⁸ UN, [Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#), 1989.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ OKB, [Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women](#)[Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave],1981.

⁴¹ Po aty.

⁴² "OZHQ 4: Sigurimi i arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë." Shih [Qeverisja Lokale në Kosovë dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm](#). Në këtë raport, qeveria e Kosovës citon në mënyrë specifike OZHQ 4.2, që i referohet qasjes në arsimin cilësor të fëmijërisë së hershme (EFH), dhe OZHQ 4.5,

OZHQ 5⁴³ përpiqet t'i japë fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave përmes legjislacionit dhe politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet. Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës miratoi Rezolutën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe themeloi Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm. Në këtë kontekst, OZHQ-të janë integruar në një mekanizëm brenda Ministrisë së Pushtetit Lokal (Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale), ku OZHQ-të specifike janë integruar në një grup prej 119 treguesish për të analizuar performancën e komunës.⁴⁴ Me integrimin e OZHQ-ve në mekanizmat e Qeverisë, Qeveria e Kosovës jo vetëm që ka treguar përkushtimin e saj ndaj këtyre synimeve, por është e detyruar të punojë drejt arritjes së këtyre OZHQ-ve.

Edhe pse Qeveria e Kosovës nuk i ka miratuar zyrtarisht Objektivat e Barcelonës në legjislacion, këto objektiva mbeten relevante për Kosovën në kontekstin e procesit të saj të anëtarësimit në BE, veçanërisht lidhur me rëndësinë e edukimit EFH për të kontribuar në fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore.

Legjislacioni, politikat dhe strategjitë e Kosovës

Kushtetuta e Kosovës

Në Kosovë, qasja e barabartë në arsim me kosto të përballeshme, barazia gjinore dhe mbrojtja nga diskriminimi janë të përmendura në Kushtetutë. Nenet 7, 22, 24 sigurojnë mbrojtje nga diskriminimi në bazë gjinore, ndërsa neni 47 u jep të drejtën vajzave dhe djemve për qasje të barabartë në arsim, duke përfshirë arsimin parashkollor në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës (neni 59).⁴⁵

Legjislacioni i Kosovës për barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Ligji për Barazinë Gjinore⁴⁶ dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴⁷ në mënyrë të qartë mbrojnë të drejtat e grave, burrave, vajzave dhe djemve nga diskriminimi i bazuar në gjini. Gjithashtu, legjislacioni (ligjet⁴⁸ dhe aktet nënligjore⁴⁹) njohin të drejtat ndërkombëtare të fëmijës. Legjislacioni siguron qasje në arsim për vajzat dhe djemtë, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi në institucionet arsimore nga arsimi parauniversitar në arsimin terciar.

Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme

Ligji më i ri për edukimin në fëmijërinë e hershme hyri në fuqi në gusht 2023.⁵⁰ Ky ligj siguron qasje të barabartë pa diskriminim për të gjitha vajzat dhe djemtë. Neni 3 mbron në mënyrë eksplicite vajzat dhe djemtë nga diskriminimi në bazë të gjinisë, etnisë, racës, gjuhës, aftësisë së kufizuar, situatave të jetesës socio-ekonomike dhe situatave të jetesës familjare. Ligji përcakton të drejtën e vajzave dhe djemve për të marrë pjesë në EFH cilësor dhe gjithëpërfshirës sipas nevojave të tyre individuale; siguron mirëqenien e vajzave dhe djemve; vendos mekanizmat për institucionet EFH; përcakton përgjegjësitë e

që i referohet qasjes gjithëpërfshirëse dhe të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që jetojnë në komunitete dhe/ose kushte jetese të cenueshme. Po ashtu, përmenden infrastruktura shkollore dhe kualifikimet e mësuesve (4.a dhe 4.c) (*Qeverisja Lokale*, f. 7).

⁴³ Qeveria e Kosovës përfshin "["OZHQ 5: Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat"](#) me fokus të veçantë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit (OZHQ 5.1) dhe në miratimin e politikave të qëndrueshme dhe legjislacionit të detyrueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet (OZHQ 5.c)" (*Qeverisja lokale*, f. 8).

⁴⁴ Shih ["Qeverisja Lokale në Kosovë dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm"](#)

⁴⁵ ["Kushtetuta e Republikës së Kosovës"](#), 15 qershor 2008.

⁴⁶ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore](#).

⁴⁷ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#); Rregullore [GRK nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucionale për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna](#).

⁴⁸ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve](#).

⁴⁹ Udhëzimi Administrativ (UA) për [Autoritetet për të Drejtat e Fëmijës](#); UA për [Këshillin për të Drejtat e Fëmijës](#); UA për [Ekipin për Mbrojtjen e Fëmijës](#).

⁵⁰ Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 08/L-153 për [Edukim në fëmijëri të hershme](#).

ofruesve të shërbimeve EFH; ofron udhëzime për zhvillimin profesional, monitorimin, inspektimin, financimin dhe sanksionimin e ofruesve të shërbimeve EFH; dhe përcakton mekanizmat monitorues për të siguruar respektimin e standardeve të cilësisë.

Qasja në arsim kërkon norma sociale, legjislacion, buxhet dhe menaxhim gjithëpërfshirës.⁵¹ Teksa ligji i referohet në mënyrë më të përgjithësuar “nevojave individuale të fëmijëve” dhe “fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore”,⁵² ekziston vetëm një referencë e qartë për gjininë⁵³ dhe nevojat e tjera ndërthurëse⁵⁴ të vajzave dhe djemve, prindërve dhe kujdestarëve gra dhe burra, dhe ofruesve të EFH. Megjithatë ligji duket se ndjek praktikën më të mira globale, ai nuk është transformues gjinor dhe as i integruar sa duhet për nevojat e tjera ndërthurëse që prekin burrat, gratë, vajzat dhe djemtë.

Më tej, UNICEF-i raporton se, përderisa legjislacioni dhe politikat e Kosovës janë kryesisht në përputhje me normat ndërkombëtare, mbeten boshllëqe të konsiderueshme ndërmjet politikave dhe zbatimit, duke përfshirë qasje të pamjaftueshme në arsim dhe kujdes; arsim me cilësi të dobët; zbatimin e politikave komunale; qasje e komuniteteve të cënueshme në EFH; dhe programe për luftimin e diskriminimit me bazë gjinore, veçanërisht në lidhje me qasjen e grave në mundësitë ekonomike, politike dhe sociale; dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.⁵⁵

Ligji për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Ky ligj përmend shprehimisht të gjithë “mësuesit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar”.⁵⁶ Ai gjithashtu përfshin në përgjithësi trajnimet dhe kualifikimet; kriteret për praktikën profesionale; Këshillin Shtetëror për përcaktimin nëse profesionistët i përmbushin kriteret; Agjencinë Shtetërore të Provimeve dhe provimin shtetëror; praktikën profesionale dhe anëtarësimin në shoqata profesionale; përgjegjësitë e Ministrisë; zhvillimin e standardeve për ushtrimin e profesionit; përgjegjësitë dhe kodin e etikës së profesionistit; masat disiplinore; dhe dispozitat kalimtare.

Ky është një ligj më i përgjithshëm që zbatohet për një gamë të gjerë praktikantësh profesionistë. Ai nuk bën referencë të qartë për parandalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, situatave socio-ekonomike, ose aftësisë së kufizuar. Për të siguruar që ofruesit e shërbimeve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (EFH) kanë kompetenca për të promovuar barazinë gjinore, për të zbatuar qasje transformuese gjinore në mësimdhënie dhe për të siguruar praktika gjithëpërfshirëse, duhet të përfshihen referenca të qarta për barazinë gjinore, aftësinë e kufizuar dhe situata të tjera socio-ekonomike të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në ligj, veçanërisht në nenet që lidhen me Këshillin Shtetëror; përgjegjësitë e Këshillit Shtetëror, ministrive dhe profesionistëve; provimin shtetëror; dhe kërkesat për Kodet e Etikës Profesionale dhe mbledhjen e të dhënave.

Ligji për Arsimin në Komunën e Republikës së Kosovës

Ky ligj rregullon organizimin e të gjitha institucioneve arsimore publike, nga arsimit parauniversitar deri në atë terciar, në komunat e Kosovës. Ai përshkruan përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave lidhur me regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore; rekrutimin; punësimin dhe pagesën e pagave; trajnimin e stafit arsimor dhe administratës; inspektimin e funksionimit të institucioneve arsimore dhe arritjeve të nxënësve; si dhe përcaktimin e tarifave.⁵⁷ Ky ligj gjithashtu përcakton përgjegjësitë administrative komunale për funksionimin e institucioneve arsimore; sigurimin e tokës për institucionet

⁵¹ UNICEF, [Gjendja e të Drejtave të Fëmijës në Kosovë](#), 2021, f. 8.

⁵² Aftësia e kufizuar dhe nevojat për arsimin special, ose vonesat në zhvillim, përmenden nëntë herë. Aftësia e kufizuar dhe nevojat për arsimin special përmenden secila tri herë në nenin 4, ku përcaktohen termat kyç. Aftësia e kufizuar përmendet shprehimisht në nenin 3, që siguron mbrojtjen nga diskriminimi, në nenin 9, që përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve të EFH, dhe në nenin 10, që përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e stafit të EFH.

⁵³ Gjinia përmendet në mënyrë të qartë një herë, në nenin 3, l.7.

⁵⁴ Komunitetet pakicë, familjet me të ardhura më të ulëta, si dhe vajzat dhe djemtë në situata të cënueshme referohen vetëm në nenin 3, që siguron mbrojtje nga diskriminimi. Për më tepër, kujdestarët të vetëm nuk përmenden fare në mënyrë eksplicite.

⁵⁵ UNICEF, [Gjendja e të Drejtave të Fëmijës në Kosovë](#), 2021, f. 5-8.

⁵⁶ Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 05/L-066 për [Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës](#).

⁵⁷ Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 03/L-068 për [Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës](#).

arsimore; ndërtimin e institucioneve arsimore; dhe identifikimin e nevojave të ndryshme arsimore të vajzave, djemve, grave dhe burrave, duke përfshirë ndërtimin e objekteve të reja arsimore dhe gjuhën e mësimdhënies dhe të mësuarit.

Në këtë ligj nuk është përfshirë mjaftueshëm perspektiva gjinore dhe as nuk ofrohen referenca të mjaftueshme për nevojat e ndryshme ndërthurëse të grave, burrave, vajzave dhe djemve në të. Janë dy referenca për përgjegjësinë e MASHTI-t për promovimin e një "sistemi arsimor jodiskriminues" dhe një politikë gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor⁵⁸. Ekziston një referencë për përgjegjësinë komunale ndaj proceseve jodiskriminuese të regjistrimit⁵⁹. Kapitulli V parasheh arsimin në gjuhën serbe dhe kompetencat e Komunës së Mitrovicës Veriore.⁶⁰ Nuk ka referenca të tjera të qarta për përgjegjësitë ose kompetencat komunale për promovimin e barazisë gjinore dhe mjedisve mësimore gjithëpërfshirëse për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në situata të ndryshme ndërthurëse.

Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Ky ligj rregullon kompetencat, përgjegjësitë dhe organizimin e Inspektoratit Arsimor; si dhe zbatimin e legjislacionit për shërbimet e zhvillimit arsimor dhe profesional.⁶¹ Ai përcakton Inspektoratin Arsimor si organ qendror ekzekutiv për sigurimin e cilësisë; definon funksionet e këtij organi; identifikon llojet e inspektimeve; rregullon dhe përcakton kriteret dhe detyrat përzgjedhëse të Inspektorëve të Arsimit; përcakton kriteret për vlerësimin e mësuesve dhe personelit administrativ; konfidencialitetin; dhe ankesat për të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH).

Edhe pse ky ligj në përgjithësi përcakton detyrat dhe kompetencat e Inspektoratit Arsimor, ai nuk bën referencë të qartë për mekanizmat ose detyrat për parandalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, ose kushteve të tjera ndërthurëse të jetesës. E vetmja referencë e qartë në lidhje me nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve është në nenin 10, i cili përcakton Inspektoratin si zyrtar publik përgjegjës për vlerësimin e ankesave për diskriminim dhe për fëmijët që përjetojnë dhunë.

Nenet 11 dhe 12 i referohen përgjegjësisë së Inspektoratit për vlerësimin e cilësisë së institucioneve arsimore dhe performancës së mësuesve dhe personelit administrativ. Megjithatë, nuk ka asnjë referencë për kompetencat dhe vlerësimin e cilësisë në lidhje me promovimin e barazisë gjinore, qasjeve transformuese gjinore, ose mekanizmave të tjerë që nxisin përfshirjen e vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuara, apo atyre në situata të tjera ndërthurëse.

Udhëzimet Administrative (UA)

UA MASHTI nr. 03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore në Kosovë rregullon përfshirjen, regjistrimin, tarifën, raportin mësues-fëmijë për vajzat dhe djemtë nga mosha nëntë muaj deri në gjashtë vjeç, oraret e punës dhe oraret e përgatitjes së mësuesve. Ky UA përshkruan në mënyrë të qartë dispozitat për vajzat dhe djemtë me aftësi të kufizuara, familjet që marrin ndihmë sociale, ata me prindër të vetëm, fëmijët që jetojnë në strehimore dhe fëmijët pa prindër.⁶² Dispozitat përfshijnë heqjen e tarifave dhe ndihmë të tjera për fëmijët me nevoja të veçanta. Megjithatë, ofrimi i asistencës për fëmijët me nevoja të veçanta dhe me aftësi të kufizuara nuk garantohet, por varet nga nëse sistemi EFH ka mjaft mësues me kompetencat e nevojshme profesionale.⁶³ Kjo mund të pengojë qasjen në shërbime të tilla.

⁵⁸ Po aty., Neni 3.

⁵⁹ Po aty., Neni 5.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 06/L-046 për [Inspektorati e Arsimit në Republikën e Kosovës](#).

⁶² UA, [MASHTI nr.03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë](#).

⁶³ Po aty., Neni 3.

UA të tjera që rregullojnë EFH janë mbi kriteret e licencimit dhe regjistrimit për institucionet private të EC⁶⁴; zbritjen e tarifave për prindërit me më shumë se një fëmijë⁶⁵; kushtet dhe mbështetje për krijimin dhe funksionimin e EFH me bazë në komunitet⁶⁶; mjetet për financimin e arsimit publik EFH⁶⁷; procedurat për përfundimin e shërbimeve EFH⁶⁸; vendosjen e orarit të punës dhe ofrimin e shërbimeve në institucionet EFH⁶⁹; vendosjen e kërkesave më të rëndësishme organizative për institucionet EFH⁷⁰; rregullimin e ofertave të shërbimit EFH për prindërit e vajzave dhe djemve nga mosha nëntë muajsh deri në gjashtë vjeç⁷¹; dhe orët totale të kontaktit dhe planifikimit për edukatorët parashkollorë.⁷² Këto UA janë më shumë teknike sesa cilësore, me përjashtim të UA që rregullon kriteret e licencimit për institucionet private. Ky UA përfshin parametra dhe kriteret specifike që synojnë të garantojnë sigurinë fizike të vajzave dhe djemve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen në institucionin EFH. Është neutral në aspektin gjinor dhe e vetmja referencë për fëmijët me nevoja të veçanta kërkon që tualeti të jetë i qasshëm.⁷³

UA të tjera relevante për SC përfshijnë: ato për zhvillimin profesional të mësuesve në shkollë⁷⁴; për financimin e zhvillimit profesional të mësuesve⁷⁵, dhe për mbikëqyrjen profesionale pedagogjike të punës së pedagogëve dhe bashkëpunëtorëve profesionistë, e cila u shfuqizua më 23 dhjetor 2021.⁷⁶ Këto UA përcaktojnë në detaje kriteret teknike për trajnimin profesional, detyrat dhe kompetencat e institucioneve të ndryshme publike, procedurat për përcaktimin e nevojave për zhvillim profesional, procedurat e sigurimit të cilësisë për vlerësimin e trajnimeve dhe kriteret dhe procedurat buxhetore. Megjithatë, asnjë nga këto UA nuk është e integruar gjinor dhe nuk përfshin nevojat e ndryshme ndërthurëse të vajzave, djemve, grave dhe burrave.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore

Strategjitë gjithashtu përmendin korrelacionin ndërmjet arsimit, fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore. Konkretisht, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj) 2020-2024 i ndërlidh sfidat e zhvillimit njerëzor, rolet gjinore dhe stereotipet me diskriminimin në arsim.⁷⁷ PKBGj ka një objektiv të përgjithshëm strategjik për “promovimin e barazisë gjinore përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithëpërfshirjes dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si faktorë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe eliminimin e pabarazive dhe stereotipeve gjinore”.⁷⁸ PKBGj identifikon qasjen në

⁶⁴ UA nr. 06/2011 | [Licencimi dhe Regjistrimi i Institucioneve Arsimore Parashkollore Private](#).

⁶⁵ UA nr.41/2007 | [Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore](#)

⁶⁶ UA nr. 42/2007 | [Kushtet dhe mundësitë për mbështetjen e arsimit parashkollor sipas komuniteteve](#).

⁶⁷ UA nr. 02/2008 për [Mjetet e dedikuara për financimin e edukimit parashkollor publik dhe mënyrat e shpenzimit të tyre](#).

⁶⁸ UA MASHTI nr. 43/2007 për [përcaktimin e procedurës, rasteve dhe afateve të ndërprerjes së punës në institucionet parashkollore](#).

⁶⁹ UA MASHTI nr. 44/2007 për [Kohëzgjatjen e programeve parashkollore](#).

⁷⁰ UA MASHTI nr. 45/2007 për [Publikimin e Organizimit të Arsimit në Institucionet Parashkollore](#).

⁷¹ UA MASHTI nr. 46/2007 për [Mënyrën e zgjedhjes së programeve parashkollore nga prindërit e fëmijëve](#).

⁷² UA MASHTI nr. 47/2007 për [fondin javor i orëve për edukatorë](#).

⁷³ Neni 9, UA nr. 06/2011 | [Licencimi dhe Regjistrimi i Institucioneve Arsimore Parashkollore Private](#).

⁷⁴ UA MASHTI nr. 119/2020 për [zhvillimin profesional të mësuesve me bazë në shkollë](#) është në fuqi për të gjithë edukatorët parauniversitarë dhe përfshin udhëzime për 'procedurat e brendshme dhe të jashtme për identifikimin e nevojave, zbatimin e aktivitetëve, mbikëqyrjen, monitorimin, certifikimin dhe vlerësimin e mësuesve' (nenet 1 dhe 2).

⁷⁵ UA MASHTI nr. 15/2013 për [Financimin e Zhvillimit Profesional të Mësuesve](#). Ky UA nuk e përmend në mënyrë që qartë edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH). Megjithatë, aty thuhet se MASHTI mund të ndajë fonde për Drejtoritë Komunale të Arsimit për aktivitetet prioritare të zhvillimit profesional. Duke qenë se MASHTI ka identifikuar EFH, këto udhëzime administrative me sa duket do të zbatohen për të mbështetur këtë fushë..

⁷⁶ UA MASHTI nr. 40/2007 për [Mbikëqyrjen Profesionale Pedagogjike të Punës së Edukatorëve dhe Bashkëpunëtorëve Profesional](#) (shfuqizuar me vendimin GRK, nr. 02/50 datë 23.12.2021).

⁷⁷ Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 Plani i Veprimit](#), 2020.

⁷⁸ Po aty., f. 11.

edukimin parashkollor me kosto të përballueshme si të rëndësishëm për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës⁷⁹ dhe për mbështetje në arritjen e rezultateve të përmirësuara arsimore.⁸⁰

Strategjia e Arsimit 2022-2026 dhe Plan i Veprimit

Fusha I e Strategjisë së Arsimit MASHTI i jep përparësi EFH-së me objektivin e përgjithshëm për të rritur përfshirjen dhe qasjen e barabartë në EFH.⁸¹ Objektivat specifike parashikojnë ndërhyrje për të rritur shërbimet EFH; përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe kompetencave të ofruesve të shërbimeve (si edukatorët ashtu edhe administratorët); hartimin e ligjeve për EFH; dhe zhvillimin e një kurrikule EFH dhe një sistemi të sigurimit të cilësisë. Në lidhje me gjetjet e UNICEF-it, MASHTI ka prioritetizuar zhvillimin e EFH-së në katër objektiva specifike të Strategjisë së Arsimit MASHTI 2022-2026 dhe Planit të Veprimit. Në përgjithësi, MASHTI duket se ka adresuar rekomandimet e UNICEF-it dhe disa nga praktikatat më të mira për EFH cilësore të bazuar në lojëra.

Në përgjithësi, Strategjia e Arsimit përfshin analiza gjinore të situatave të grave, burrave, vajzave dhe djemve dhe parashikon mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Në analizat gjinore që lidhen me EFH, Strategjia përmend barazinë e ulët gjinore në fuqinë punëtore EFH, përhapjen e stereotipeve gjinore në sektorin e arsimit, në materialet mësimore dhe praktikatat në klasë.⁸² Situatat dhe nevojat ndërthurëse të grave, burrave, vajzave dhe djemve gjithsesi marrin parasysh përfshirjen e ulët të vajzave dhe djemve romë, ashkali dhe egjiptianë; vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuara; dhe përfshirjen e ulët në EFH në zonat rurale.

Ndërkohë që Strategjia e Arsimit MASHTI duket të ketë integruar perspektivën gjinore minimalisht me disa komponentë të përgjegjshëm gjinor, zhvillimi i politikave dhe mekanizmave që lidhen me EFH nuk është mjaftueshëm i fokusuar ndaj aspektit gjinor apo nuk i përgjigjet të gjitha nevojave ndërthurëse të familjeve. Ka disa referenca për zhvillimin e legjislacionit për rritjen e regjistrimit të vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane dhe ata me aftësi të kufizuara. Megjithatë, nuk ka referenca për strategjitë që rrisin regjistrimin e familjeve me të ardhura më të ulëta, që është gjithashtu e rëndësishme për rritjen e angazhimit të grave kujdestare në tregun e punës.

Plan i Veprimit ka disa veprime dhe tregues përkatës që integrojnë në mënyrë eksplicite masa të përgjegjshme gjinore që kanë të bëjnë me kurrikulat EFH dhe qasjet pedagogjike. Veprimet e parashikuara përfshijnë rishikimin gjinor të teksteve dhe materialeve mësimore duke përdorur *Manualin për Parandalimin e Stereotipeve Gjinore në Tekste Shkollorë*⁸³; ndërgjegjësimin e përgjegjshëm gjinor mbi rëndësinë e EFH⁸⁴ dhe strategjitë e rekrutimit të përgjegjshëm gjinor për profesionistët e EFH.⁸⁵ Megjithatë, qasjet transformuese gjinore për luftimin e stereotipeve diskriminuese gjinore nuk janë shprehur gjithmonë në mënyrë eksplicite në përgjithësi. I paraparë në Strategjinë e Arsimit, por jo në Planin e Veprimit, është trajnimi për edukatorët që kontribuojnë në barazinë gjinore.⁸⁶ Së fundi, shumë tregues të përmendur në Strategjinë dhe Planin e Veprimit nuk duket se matin se sa transformuese apo të përgjegjshme janë veprimet.

UNICEF identifikon prioritetizimin dhe investimin e ulët në EFH; mekanizmat e dobët të sigurimit të cilësisë; mungesën e politikave për zgjerimin e përgjegjshëm dhe të barabartë të EFH për të gjithë fëmijët, veçanërisht fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë dhe familjet me status më të ulët socio-ekonomik

⁷⁹ Po aty., f. 13.

⁸⁰ EC, [Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth](#) [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse], 2013, p. 4.

⁸¹ Objektivi Strategjik I ka për qëllim rritjen e përfshirjes dhe qasjes së barabartë në Edukimin Cilësor në Fëmijërinë e Hershme (EFH): 'ritja e numrit të Institucioneve Parashkollorë (IP) dhe organizimi i shpërndarjes së tyre në mënyrë adekuate; zhvillimi i kornizës ligjore dhe kurrikulës për EFH; krijimi i një mjedisi arsimor cilësor; ndërtimi i infrastrukturës së përshtatshme për fëmijët; dhe mbështetje ndërthurëse në ofrimin e shërbimeve cilësore në EFH' (MASHTI, [Strategjia e arsimit 2022-2026](#), 2022, f. 59).

⁸² Po aty., f. 39-40.

⁸³ MASHTI, [Strategjia e arsimit 2022-2026 Plan i veprimit](#), 2022, f. 8, 40.

⁸⁴ Po aty., f. 13.

⁸⁵ Po aty., f. 14.

⁸⁶ Po aty., f. 61.

si barriera për të drejtën e vajzave dhe djemve për arsim.⁸⁷ Në mënyrë të ngjashme, dhe në lidhje me shërbimet EFH të qasshme dhe me kosto të përballeshme, UNICEF përmend angazhimin e kufizuar të sektorit privat dhe furnizimin e ulët të EFH kosto të përballeshme si një pengesë për qasjen e barabartë në EFH, gjë që kontribuon në rritjen e kostove të EFH.⁸⁸

Megjithëse masat legislative dhe politike dhe investimi në EFH të qasshme dhe të përballeshme janë identifikuar si një objektivi specifik në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Arsimin MASHTI,⁸⁹ treguesit që matin arritjen e këtij objektivi nuk matin në mënyrë të qartë cilësinë ose sa të përgjegjshme janë veprimet e parashikuara në aspektin gjinor. Edhe pse disa tregues janë të ndarë sipas gjinisë, ata janë më sasiorë dhe matin rritjen e regjistrimit të vajzave dhe djemve dhe numrin e institucioneve të reja ose të rinovuara të EFH të ndërtuara. Megjithatë, pikënisjet dhe treguesit nuk ndahen sipas gjinisë ose dallimeve të tjera ndërthurëse si përkatësia etnike, aftësia e kufizuar ose situata socio-ekonomike e familjeve. Në mënyrë të ngjashme, shkalla në të cilën buxhetimi është i përgjegjshëm gjinor, ose i përgjigjet situatave të ndryshme ndërthurëse të palëve të interesuara nuk është e evidente në Strategjinë e Arsimit dhe Planin e Veprimit.

Mbledhja dhe raportimi i të dhënave institucionale

Përderisa Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka grupe të dhënash që tregojnë se po mbledhen të dhëna të ndara sipas gjinisë, ato nuk përshkruajnë gjithmonë nevojat e ndryshme arsimore të vajzave dhe djemve nëpër demografitë ndërthurëse. Kjo pengon përdorimin e të dhënave të bazuara në prova për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme në lidhje me objektet dhe shërbimet EFH (p.sh., politikat, planifikimi, buxhetimi, ofrimi i shërbimeve, zhvillimi profesional, ngritja e ndërgjegjësimit). Në mënyrë të ngjashme, MASHTI ka raportuar të dhëna për shkollat publike, të ndara sipas rajonit, klasës, lëndës, roleve institucionale dhe regjistrimit të nxënësve sipas gjinisë. Disa të dhëna sasiorë të lidhura me nevojat arsimore janë të disponueshme nëpër demografi të ndryshme ndërthurëse dhe situata sipas gjinisë, por ato nuk tregojnë gjithmonë demografinë dhe situatat ndërthurëse për të gjitha grupmoshat EFH. Të dhënat e ndara sipas gjinisë që lidhen me regjistrimin e djemve dhe vajzave, si dhe demografinë e mësuesve dhe stafit në institucionet EFH në gjuhën serbe janë të kufizuara. Po ashtu, regjistrimi aktual dhe demografia organizative në institucionet private EFH mund të mos pasqyrohen plotësisht në grupet e të dhënave të ASK-së, pasi jo të gjitha institucionet private kanë regjistruar dhe/ose raportuar të dhëna të ndara sipas gjinisë.⁹⁰

“

Të dhënat të ndara sipas gjinisë për regjistrimet dhe demografinë e stafit në institucionet parashkollore në gjuhën serbe janë të kufizuara.

”

Standardet e EFH, tekstet shkollore, materialet e mësimit dhe udhëzime të tjera

Raporti vjetor i UNICEF-it për vitin 2023 përmend bashkëpunimin me MASHTI-n në hartimin e kurrikulave bazë/obligative për vajzat dhe djemtë nga lindja deri në moshën gjashtë vjeç; parashikohet

⁸⁷ UNICEF, *Gjendja e të Drejtave të Fëmijës në Kosovë*, 2021, f. 8.

⁸⁸ Po aty., f. 8.

⁸⁹ “1.1 Objektivi specifik: Krijimi i mjediseve të shëndetshme me kushte adekuate për EHF dhe sigurimi i burimeve njerëzore” (MASHTI, *Strategjia e arsimit 2022-2026, Plani i veprimit*, 2022).

⁹⁰ Mevlude Aliu Gashi, Zehrie Plakolli, et. al., *Cidree Yearbook 2022, Challenges facing the organisation and realisation of pre-school education in Kosovo*, 2022.

që këto kurrikula të pilotohet në vitin 2024.⁹¹ Lidhur me këtë, më 8 dhjetor 2023, MASHTI njoftoi nisjen e trajnimit të trajnerëve për pilotimin e kurrikulave EFH.⁹² Kjo do të jetë hera e parë që kurrikula specifike për EFH pilotohet për vajzat dhe djemtë nga lindja deri në moshën tre vjeçare. Meqenëse kurrikula më e re nuk është ende në dispozicion për publikun, nuk mund të vlerësohet nëse kurrikulat janë të përgjegjshme apo transformuese në aspektin gjinor.

Megjithatë, para kësaj arritjeje, kurrikulat për vajzat dhe djemtë nga lindja deri në moshën pesë vjeçare dhe për moshat parafillore pesë deri në gjashtë janë përshkruar minimalisht në shtatë fusha lëndore, pa iu referuar kompetencave, në Kornizën e Kurrikulës Parauniversitare si nivel SNKA 0.⁹³ Në mënyrë të ngjashme, aktivitetet mësimore referohen minimalisht. Shembujt përfshijnë: “aktivitete që nxisin komunikimin duke përdorur gjuhën” dhe “aktivitete që nxisin shprehjen artistike”.⁹⁴ Në vitin 2018, kurrikula për vajza dhe djem në nivelin parafillor (moshat pesë dhe gjashtë) u rishikua dhe tani ka një planprogram më të detajuar për secilën lëndë (gjithsej shtatë).⁹⁵ Gjuha dhe shembujt e përdorur në përshkrimet e kurrikulës e kanë minimalisht të integruar perspektivën gjinore; përshkrimi i kurrikulës përdor terma asnjans gjinor si “fëmijët” dhe përemrat mashkullor dhe femëror “ai/ajo” dhe “i tij/saj”. Megjithëse në pjesën hyrëse theksohet rëndësia e mundësive të barabarta për vajzat dhe djemtë në të gjitha aktivitetet, nuk ka shembuj të mësimëve që janë transformuese gjinore. Për më tepër, disa përshkrime vazhdojnë të përdorin terma gjinor; për shembull, në seksionin “Shkencat natyrore” përdoret termi mashkullor “njeriu dhe natyra”.⁹⁶

Megjithatë, *Standardet e Zhvillimit të Mësimi të Hershëm për Fëmijët e moshës 0-6 vjeç*,⁹⁷ të botuara nga MASHTI, ofrojnë disa udhëzime për aktivitetet EFH për vajzat dhe djemtë. Ky publikim pranon se pabarazia gjinore përforcohet nga komunikimi dhe zhvillimi gjuhësor brenda dhe jashtë shtëpisë dhe thekson se kujdestarët dhe mësuesit që zbatojnë aktivitetet duhet t'i kushtojnë vëmendje trajtimit të barabartë të vajzave dhe djemve, si dhe stereotipeve gjinore në lidhje me qëndrimet, rolet dhe besimet për anëtarët e familjes dhe kujdestarët.⁹⁸ Janë përmendur në mënyrë të qartë shembuj transformues gjinor të aktivitetëve për vajzat dhe djemtë nga lindja deri në moshën gjashtë vjeçare. Kjo mund të shërbejë si një shembull i mirë kur zhvillohen kurrikulat EFH, duke përshkruar mundësitë e të mësuarit dhe planet e mësimi që janë transformuese gjinore.

MASHTI raporton se projektligji për tekstet shkollore është finalizuar në vitin 2022 dhe është miratuar nga Qeveria e Kosovës.⁹⁹ Ky ligj parashikon ofrimin e manualeve për mësuesit me udhëzime se si të hartohen planet mësimore sipas kurrikulës bazë/obliguese; mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve; masat për sigurimin e kompetencave të recensentëve të teksteve shkollore; pilotimin e teksteve shkollore; rishikimin e vazhdueshëm të teksteve shkollore; digitalizimin e teksteve shkollore; mundësitë për përkthimin e teksteve shkollore; dhe ngritjen e kapaciteteve për Këshillin Shtetëror të krijuar për rishikimin e teksteve shkollore.¹⁰⁰ Ndërtimi i kapaciteteve kryesisht referon në mënyrë eksplicite kompetencat që lidhen me vlerësimin e bazuar në shkencën e të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijës; zbatimin e kurrikulave, lëndëve dhe digitalizimin; dhe qasje të ndryshme moderne të mësimdhënies që janë gjithëpërfshirëse dhe promovojnë barazinë gjinore.¹⁰¹ Megjithatë, nuk ka referenca specifike për tekstet shkollore të EFH, materialet mësimore dhe lodrat. Si i tillë, nuk është e qartë se si do të zbatohet ky ligj për materialet mësimore të EFH dhe trajnimin e mësuesve të EFH.

Në veçanti, ekziston një manual i ABGj-së për mësuesit për të vlerësuar tekstet shkollore; megjithatë, duket se nuk i referohet në mënyrë specifike teksteve shkollore EFH, materialet mësimore

⁹¹ UNICEF Zyra e UNICEF-it në Kosovë, [Country Office Annual Report 2023](#) [Raporti vjetor].

⁹² MASHTI, “[MASHTI ka filluar trajnimin e trajnerëve për pilotimin e kurrikulës për EFH](#)”, 8 dhjetor, 2023.

⁹³ MASHTI, [Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës \(e rishikuar\)](#), 2016.

⁹⁴ Po aty., f. 39.

⁹⁵ MASHTI, [Kurrikula/Programet mësimore lëndore. Klasa përgatitore](#), 2018.

⁹⁶ Po aty., f. 55.

⁹⁷ MASHTI, [Standardet për zhvillim dhe mësimi të hershëm për fëmijët e moshës 0-6 vjeç](#), tetor 2011.

⁹⁸ Po aty., f. 33, 45

⁹⁹ MASHTI, “[Ministria Nagavci mori pjesë në dëgjimin publik të projektligjit për tekstet shkollore](#)”, 27 mars 2024.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

dhe lodrave.¹⁰² Megjithëse doracak për tekstet shkollore ofron strategji për rishikimin e transformimit gjinor të imazheve dhe formulimeve, ai nuk ofron udhëzime specifike në lidhje me strategjitë për zgjedhjen dhe përdorimin e materialeve dhe lodrave potencialisht transformuese dhe gjithëpërfshirëse gjinore. Në prill të vitit 2023, MASHTI publikoi një doracak për edukimin e diversitetit kulturor, i cili ofron strategji për zhvillimin e mjediseve mësimore më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e arsimit për kultura, raca, etni të ndryshme, etj.¹⁰³ Megjithatë, ky manual nuk ofron plane specifike mësimore për EFH. Më tej, megjithëse në pjesën hyrëse theksohet rëndësia e mësimdhënies rreth kulturave të ndryshme, racave, etnive dhe barazisë gjinore, shumë nga imazhet në libër duket se pasqyrojnë role stereotipike gjinore dhe ka më shumë plane mësimore që i referohen burrave të shquar historikë sesa grave.

Në lidhje me infrastrukturën dhe rritjen e qasjes në institucionet EFH, ekzistojnë udhëzime për standardet e strukturave institucionale të EFH.¹⁰⁴ Këto udhëzime përshkruajnë standardet e ndërtimit të bazuar në aftësitë zhvillimore të vajzave dhe djemve nga lindja deri në moshën gjashtë vjeçare, duke përfshirë mobilet e përshtatshme, hapësirat e mësimi, zonat higjienike, hapësirat e ngrënies, dhe zonat e lojërave në natyrë. Udhëzimet i referohen nevojave të ndryshme të vajzave, djemve, grave dhe burrave, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara fizike. Këto udhëzime parashikojnë gjithashtu hapësira operative të nevojshme për shërbime administrative dhe shërbime të tjera si pedagogë, infermierë, etj., si dhe protokoll për garantimin e sigurisë fizike dhe të sigurisë së vajzave dhe djemve. Megjithatë, udhëzimet nuk ofrojnë specifiktet mënyra për t'u siguruar që vendndodhja e objektit të plotësojë nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve, përveç atyre me aftësi të kufizuara fizike.

Shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme, regjistrimi dhe stafi

Ndërkohë, disponueshmëria e shërbimeve të përbalueshme për EFH mbetet e ulët, duke penguar pjesëmarrjen e barabartë të grave në fushat politike, ekonomike dhe sociale të jetës.¹⁰⁵ Në lidhje me koston e institucioneve parashkollore, të ardhurat mesatare të Kosovës të raportuara në vitin 2022

mbeten të ulëta (521 € në muaj).¹⁰⁶ Po ashtu, pjesëmarrja e grave në tregun e punës në vitin 2022 ishte 18%, krahasuar me 49% të burrave.¹⁰⁷ Edhe pse të dhënat statistikore për pjesëmarrjen e grave dhe burrave romë, ashkali dhe egjiptianë në tregun e punës janë minimale, dihet që pjesëmarrja e tyre është më e ulët. Të dhënat për vitin 2022 gjithashtu tregojnë norma më të larta të papunësisë te gratë

(16.5%) krahasuar me burrat (11%).¹⁰⁸ Mungesa e institucioneve publike EFH me kosto të përbalueshme dhe/ose falas, veçanërisht në rajonet rurale ku papunësia është më e lartë (më shumë se 40%),¹⁰⁹ mund



Mungesa e institucioneve parashkollore të përbalueshme në zonat rurale me papunësi të lartë pengon regjistrimin e fëmijëve.



¹⁰² ABGj, [Parandalimi i stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore, udhëzues metodologjik](#).

¹⁰³ Shih faqen zyrtare të MASHTI për [Doracak për mësimdhëniesit, ndërkulturalizmi në arsim](#).

¹⁰⁴ MASHTI, [Udhëzime për normat dhe standardet për hapësirat e objekteve parashkollore](#), 2018.

¹⁰⁵ RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018, f. 33.

¹⁰⁶ ASK, ["Agjencia e Statistikave të Kosovës"](#), qasur më 15 prill 2024.

¹⁰⁷ ASK, ["Të dhënat e ASK: Anketa e Fuqisë Punëtore"](#), 2022, qasur më 15 prill 2024.

¹⁰⁸ ASK, ["Të dhënat e ASK: Papunësia dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grupmoshës, 2012-2022"](#), 2022, qasur më 15 prill 2024.

¹⁰⁹ Vigan Behluli, [Mapping of Early Childhood Development Services in Kosovo](#), 2020.

të ndikojë negativisht në shkallët e regjistrimit të fëmijëve në EFH dhe të ndikojë në angazhimin e grave në tregun e punës.¹¹⁰

Numri i institucioneve publike parashkollore dhe parafillore duket mjaft i ulët, me vetëm 54 institucione publike EFH¹¹¹ dhe 172 institucione private të licencuara.¹¹² Ndërsa shumica e komunave duken të kenë të paktën një EFH publike, shumica e instituteve private të regjistruara janë në Prishtinë. Të dhënat tregojnë se familjet që jetojnë në rajonet rurale mund të kenë qasje të kufizuar në shërbimet publike dhe private EFH. Nuk ka informacione për numrin e institucioneve EFH në Serbi dhe në disa komuna të tjera, përveç Graçanicës, ku ka dy institucione private EFH.¹¹³

Në përgjithësi, regjistrimi i vajzave dhe djemve më të rinj se pesë vjeç në institucionet parashkollore në Kosovë është mjaft i ulët (20%), ndërsa shkalla e regjistrimit është më e lartë në nivelin parafilor (89%).¹¹⁴ Një përqindje pak më e lartë e djemve (52%) sesa e vajzave (48%) janë të angazhuar në EFH (shih [Aneksin/ Grafikon 2](#)).¹¹⁵ Megjithatë, përqindja e saktë e vajzave dhe djemve nuk është në dispozicion.¹¹⁶ Regjistrimi dallon sipas rajonit, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe situatave socio-ekonomike, ku pjesëmarrja e vajzave dhe djemve që jetojnë në rajonet rurale, përkasin komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, kanë aftësi të kufizuara dhe janë në familje që marrin ndihmë sociale, janë zakonisht më të ulëta.¹¹⁷

Ngjashëm me statistikat globale, të dhënat e disponueshme tregojnë se numri i edukatorëve dhe kujdestarëve burra të EFH në Kosovë është shumë i ulët. Sipas të dhënave të ASK-së, aktualisht vetëm



Figura 12. Vetëm dy burra janë të regjistruar si mësues në institucionet publike parashkollore (3%).

dy burra janë të regjistruar si mësues në institucionet publike parashkollore (0-4 vjeç) (3%).¹¹⁸ Barazia gjinore për mësuesit në nivelin parafilor nuk është shumë e qartë, pasi të dhënat nuk ndahen sipas nivelit të klasës. Në nivelin parafilor, numri i mësuesve gra dhe burra raportohet kolektivisht për nivelet parashkollore, fillore dhe të mesme të ulëta. Po ashtu,

¹¹⁰ Shih RrGK, [Nën hije, analiza gjinore e punës joformale në Kosovë](#). Raporti vëren se mungesa e edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH) të përballueshëm është një nga arsyet kryesore pse gratë nuk janë të punësuara. Në këtë raport rekomandohet formalizimi i punës së kujdesit joformal, për shembull, nëpërmjet ofruesve të shërbimeve në institucionet EFH.

¹¹¹ MASHTI, [Statistikat e Arsimit në Kosovë](#), 2023.

¹¹² MASHTI, [Lista shkollave të licencuara parashkollore dhe parafillore](#), qasur më 15 prill 2024.

¹¹³ Po aty., Aneks, grafiku I.

¹¹⁴ MASHTI, [Raport Vjetor Statistikor me Tregues Arsimorë 2021-2022](#), f. 83-85. Kryesisht, përqindja totale e vajzave dhe djemve të regjistruar në EFH 0-6 nuk është e përmendur në Raportin më të fundit Statistikor Vjetor të MASHT-it për vitin 2022-2023.

¹¹⁵ MASHTI, [Statistikat e Arsimit në Kosovë](#), 2023

¹¹⁶ Numri i vajzave dhe djemve të moshës 0-6 vjeç në Kosovë nuk përmendet në dokumentet e MASHTI-t. Bazuar në raportin 2021-2022, duket se MASHTI po përdorë të dhënat e regjistrimit nga viti 2011. ASK i ndan të dhënat e popullsisë sipas grup-moshave, por ato ndahen në kategoritë prej 0-4 dhe 5-9. Për këtë arsye, numri i saktë i vajzave dhe djemve në grup-moshën parashkollore (5-6 vjeç) nuk është në dispozicion për publikun.

¹¹⁷ Shih aneksin [Tabela 1](#), grafiku [3](#), [4](#) dhe [5](#).

¹¹⁸ MASHT, [Statistikat e Arsimit në Kosovë](#), 2023, f. 37-45.

të dhënat e disponueshme tregojnë përqindje më të larta të grave administrative (89%) dhe stafit mbështetës (67%) që punojnë në institutet publike parashkollore (0-4 vjeç), ndërsa administratorët dhe stafi mbështetës që punojnë vetëm në nivelin parafillor nuk ndahen sipas niveleve të klasës.¹¹⁹

Përfundim

Studimet globale pohojnë se, pavarësisht rritjes së barazisë gjinore midis vajzave dhe djemve në EFH, arsimit cilësor që lufton stereotipet gjinore ende mungon.¹²⁰ Edhe pse qasja dhe regjistrimi në EFH mund të kontribuojnë në fuqizimin ekonomik të grave në përgjithësi, qasja në vete nuk është e mjaftueshme për të transformuar stereotipet gjinore të dëmshme dhe diskriminuese.

Përkundër se raportet e referuara në këtë dokument përshkruajnë arritjet dhe pengesat në ofrimin e arsimit cilësor në Kosovë, pak prej tyre vlerësojnë cilësinë e EFH dhe shkallën në të cilën kurrikulat dhe pedagogjia kosovare promovojnë barazinë gjinore dhe transformimin e normave diskriminuese gjinore. Këto raporte kryesisht identifikojnë arritjet në legjislacionin arsimor, zbatimin e legjislacionit në nivel komunal dhe shkollor, si dhe sfidat e pazgjidhura në zbatimin e kurrikulave dhe zhvillimin profesional të mësimitdhënësve. Ato nuk vlerësojnë (ri)hartimin dhe zbatimin e kurrikulave, pedagogjisë dhe politikave për të transformuar stereotipet gjinore dhe normat përkatëse gjinore për të promovuar barazinë gjinore.

Edhe pse legjislacioni dhe mekanizmat në Kosovë sigurojnë qasje në arsim për vajzat dhe djemtë, si dhe mbrojtje nga diskriminimi në institucionet arsimore, një qasje transformuese gjinore nuk aplikohet në praktikë. Për më tepër, ndjekja e arsimit parashkollor, veçanërisht për vajzat dhe djemtë e moshës 0-4 vjeç, ku duhet të fillojë një qasje e tillë, mbetet e ulët për shkak të mungesës së institucioneve parashkollore me kosto të përbalueshme. Kjo ndikon në shkallën e ulët të punësimit të grave, për shkak të roleve të tyre tradicionale sociale si kujdestare; në performancën e ulët arsimore të fëmijëve; si dhe në dështimin e Kosovës për të arritur objektivat e Barcelonës të përcaktuara nga BE.¹²¹

Sa i përket disponueshmërisë së shërbimeve (si infrastruktura, arsimit cilësor dhe politikat), UNICEF-i ka arritur në përfundimin se arsimit gjithëpërfshirës nuk është prioritet në Kosovë. Standardet për përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe stigmat sociale vazhdojnë të jenë barriera për krijimin e një mjedisi të favorshëm që mbështet qasjen e përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në arsim. Kjo përfshin infrastrukturën e paarrtshme, transportin e kufizuar, mbështetjen e vogël për qendrat mësimore, veçanërisht për familjet rome, ashkali dhe egjiptiane, si dhe numrin e pamjaftueshëm të mësuesve dhe asistentëve të trajnuar siç duhet.¹²² Pengesa të tjera që ndikojnë në vijimin e shkollës për vajzat dhe djemtë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, si dhe nga familjet me të ardhura të ulëta, përfshijnë kushtet e këqija të jetesës, normat sociale që i mbajnë vajzat në shtëpi, ngacmimet dhe ndërjegjësimin e ulët të prindërve dhe kujdestarëve për rëndësinë e arsimit.¹²³

Lidhur me cilësinë e arsimit, barrierat përfshijnë investimet e ulëta në arsim; të dhëna të kufizuara ndërthurëse të ndara sipas gjinisë; kurrikula që nuk pasqyrojnë kërkesën e tregut; trajnim të pamjaftueshëm të mësuesve; mekanizma të dobët të sigurimit të cilësisë; planifikim të dobët për sigurimin e objekteve adekuate që pasqyrojnë dendësinë e popullsisë në rajonet rurale dhe urbane; objekte arsimore me cilësi të ulët; vëmendje të kufizuar ndaj zotësisë dhe kompetencave digjitale; qasje pedagogjike; arsimim të ulët të prindërve; dhe qasje të kufizuara në mundësitë e EFH për vajzat dhe djemtë.¹²⁴

¹¹⁹ Po aty. Shih [Aneksin, grafikun 6.](#)

¹²⁰ UNICEF, [Tackling Gender Inequality From the Early Years, Strategies for Building a Gender Transformative Pre-primary Education System](#), 2022, f. 9.

¹²¹ EC, [Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth](#) [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse], 2013, f. 4. Shih RrGK, [Kush kujdeset?](#), 2016, f. 8, i cili citon gjithashtu këto çështje.

¹²² UNICEF, [Gjendja e të Drejtave të Fëmijës në Kosovë](#), 2021, f. 8.

¹²³ Po aty., f. 8.

¹²⁴ Po aty., f. 8.

Meqenëse aktet nënligjore, politikat dhe kurrikulat formale të EFH ende nuk janë finalizuar në Kosovë, nuk është e qartë nëse institucionet po integrojnë ose kanë plane të mjaftueshme për të integruar një qasje transformuese gjinore në EFH. Si rezultat, cilësia dhe shkalla në të cilën kurrikulat e EFH dhe mjediset mësimore janë transformuese gjinore nuk mund të vlerësohen plotësisht në këtë moment.

Në lidhje me zbatimin e kurrikulave transformuese gjinore, RrGK nuk ka mundur të gjejë një rishikim gjinor të publikuar të teksteve shkollore në mbarë vendin. Megjithatë, MASHTI ka deklaruar se të gjitha kurrikulat e reja janë rishikuar nga perspektiva gjinore. Në vitin 2007, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) publikoi një raport që vlerësonte përgjegjshmërinë gjinore të teksteve, materialeve mësimore dhe pedagogjisë në shkollat parafillore, fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Raporti tregoi se materialet mësimore, pedagogjia dhe qëndrimet e nxënësve reflektonin dhe përjetësonin paragjykimet dhe stereotipet gjinore.¹²⁵ Po ashtu, RrGK, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), dhe Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë raportuar se tekstet shkollore kontribuojnë në ruajtjen e normave gjinore në Kosovë.¹²⁶ Veçanërisht, ABGj ka zhvilluar një manual për rishikimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore, i cili përfshin shembuj të llojeve të lojërave (të zbatueshme edhe në mjediset mësimore të EFH), duke përdorur një qasje gjinore.¹²⁷ Megjithatë, shembujt e dhënë nuk përshkruajnë mënyrën e integritit të lodrave në mundësitë e të mësuarit në EFH sipas kurrikulave aktuale. Për më tepër, teksta disa lloje të lodrave janë përmendur në shembujt me foto, nuk është dhënë një listë specifike e lodrave neutrale gjinore që janë të disponueshme në Kosovë. Strategjia e Arsimit, gjithsesi, parashikon një rishikim gjinor të materialeve mësimore dhe lodrave në EFH.

Aktualisht, ligjet e Kosovës për sigurimin e cilësisë të përmendura në këtë dokument parashikojnë mekanizma që përcaktojnë kompetencat minimale të mësimdhënies, procedurat komunale për sigurimin e standardeve cilësore të zbatimit të kurrikulave, praktikat pedagogjike dhe një manual për mësuesit që vlerëson shkallën në të cilën tekstet shkollore përjetësojnë stereotipet gjinore. Këta mekanizma për sigurimin e cilësisë i referohen kryesisht arsimit fillor deri te ai terciar. Megjithatë, ka pasur përpjekje për të përmirësuar sigurimin e cilësisë në EFH, duke synuar rritjen e disponueshmërisë së ofruesve të licencuar cilësor të EFH (dhe, në këtë mënyrë, rritjen e regjistrimit të vajzave dhe djemve të moshës 2-6 vjeç), përditësimin e kurrikulave dhe legjislacionit për zbatimin e tyre, përmirësimin e kompetencave të mësuesve dhe zbatimin e kurrikulave të bazuara në lojë. Legjislacioni ekzistues që garanton cilësinë e arsimit parashkollor dhe parafillor rregullon standardet e arsimit të përgjithshëm, standardet për objektet, licencimin e ofruesve të EFH, trajnimin dhe edukimin para shërbimit, kompetencat profesionale të mësuesve dhe stafit të EFH, numrin e fëmijëve për mësues dhe ushqimin.¹²⁸

Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) ka konstatuar përmirësime cilësore në institucionet parashkollore, si dhe mundësi për zhvillimin profesional të edukatorëve, mbështetje për fëmijët dhe familjet e të cilëve marrin përfitime sociale, dhe inspektime të cilësisë së arsimit.¹²⁹ Megjithatë, IPK ka theksuar se fushat e mëposhtme kërkojnë përmirësime: monitorimi i cilësisë së mjediseve mësimore private dhe publike të EFH, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve parashkollore dhe MASHTI-t, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve parashkollore dhe Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), bashkëpunimi ndërmjet drejtuesve dhe edukatorëve, bashkëpunimi i institucioneve parashkollore me prindërit, dhe arsim më cilësor në institucionet parashkollore.¹³⁰

Ndërsa arritjet e përmendura të SC ofrojnë kritere për vlerësimin dhe sigurimin e shërbimeve cilësore në EFH, shkalla në të cilën mekanizmat dhe sistemet ekzistuese të SC janë përgjigjur ndaj

¹²⁵ QKSGj, *Auditim të Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor*, Prishtinë, 2007.

¹²⁶ Shih RrGK, *Analiza gjinore e Kosovës*, 2018 dhe *Kush kujdeset?*, 2016; KEC, *Barazia gjinore në tekstet shkollore gjatë nëntë viteve të arsimit të detyrueshëm në Kosovë*, 2007; dhe BIRN *Problemet dhe të meta e teksteve shkollore: Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët (Klasa VI, VII, VIII dhe IX)*, 2013.

¹²⁷ ABGj, *Parandalimi i stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore, udhëzues metodologjik*.

¹²⁸ Mevlude Aliu Gashi, Zehrie Plakolli, et. al. *Cidree Yearbook 2022. Challenges facing the organisation and realisation of pre-school education in Kosovo*.

¹²⁹ Aliu-Gashi, M., et al., KPI, *Edukimi parashkollor në Kosovë - Arritjet dhe sfidat në Kërkime Pedagogjike*, 2021.

¹³⁰ Po aty.

situatave dhe nevojave të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve duket minimale. Mekanizmat ekzistues të SC-së që adresojnë çështjet gjinore përfshijnë: zyrtarët gjinorë në MASHTI dhe DKA, ABGj, dhe manualin për mësuesit *'Parandalimi i stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore,' një udhëzues metodologjik*. Ndërhyrjet e parashikuara për sigurimin e cilësisë përfshijnë: strategjitë e rekrutimit për angazhimin e më shumë mësuesve të EFH-së nga mes burrave; një rishikim gjinor i materialeve mësimore, duke përfshirë lodrat; trajnime për profesionistët e EFH; trajnime për zyrtarët publikë në nivel kombëtar dhe vendor për mbledhjen e të dhënave dhe praktikën e monitorimit; hartimin e një kuadri monitorimi dhe strategjish në lidhje me legjislacionin, politikën dhe standardet e EFH (institucionale dhe pedagogjike); dhe një rishikim i procedurave të licencimit për institucionet EFH.¹³¹ Megjithatë, trajnimet për profesionistët dhe zyrtarët publikë të EFH nuk trajtohen në mënyrë eksplicite nga perspektiva gjinore në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 dhe Planin e Veprimit. Edhe pse Planin e Veprimit parashikon veprime të shumta për sigurimin e cilësisë, vetëm disa veprime janë mjaftueshëm të përgjegjshme gjinore dhe potencialisht transformuese. Këto përfshijnë rekrutimin e më shumë profesionistëve të EFH nga mesi i burrave, rishikimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore, dhe angazhimin e baballarëve në EFH për vajzat dhe djemtë.

Rekomandimet

Qasjet transformuese gjinore duhet të integrohen në të gjithë legjislacionin, politikën, sektorët, mekanizmat, infrastrukturën, ofrimin e shërbimeve, trajnimin, sigurimin e cilësisë, si dhe në kurrikulat dhe pedagogjinë për të gjitha nivelet e arsimit. Rekomandimet për zbatimin e kurrikulave duhet të bazohen në aftësitë zhvillimore të vajzave dhe djemve të regjistruar në programet EFH, në situatat dhe nevojat e ndryshme të vajzave, djemve, grave dhe burrave, si dhe në situatat dhe nevojat e tyre të ndryshme ndërthurëse.¹³² Për një edukim transformues gjinor, qeveria dhe ofruesit e shërbimeve EFH duhet të adoptojnë një qasje holistike dhe të koordinuar për planifikimin, hartimin, zbatimin, buxhetimin dhe sigurimin e cilësisë së kurrikulave EFH në nivel kombëtar, lokal, komunal, shkollor dhe familjar.¹³³ Rekomandimet në këtë seksion bazohen në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe janë të rëndësishme në bazë të të dhënave të disponueshme në Kosovë. Ato janë grupuar sipas kategorive të praktikave më të mira ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se institucionet e Kosovës janë në proces të zhvillimit të kurrikulave dhe standardeve për EFH, rekomandimet për planifikimin dhe Planin e Veprimit mund të jenë prioritet, ndërkohë që duhet të shqyrtohen dhe përgatiten rekomandime të tjera për zbatim në të ardhmen..

Planifikimi dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

- Të sigurohet që analizat e situatës në nivel kombëtar dhe komunal të përfshijnë analiza gjinore të situatave dhe nevojave të ndryshme ndërthurëse të vajzave, djemve, grave dhe burrave të ndryshëm. Të kryhen analiza ndërthurëse që marrin parasysh gjininë dhe përkatësinë etnike, gjuhën, aftësinë e kufizuar, rajonin (urban dhe rural), dhe situatat socio-ekonomike familjare. Analizat gjinore duhet të vlerësojnë situatat të ndryshme që lidhen me kërkesën, ofertën dhe skemat sociale, duke përfshirë: kushtet e qasjes për vajzat dhe djemtë, koston, shtrirjen e qasjes, komoditetin e vendndodhjes për gratë dhe burrat me nevoja të ndryshme në rajone të ndryshme (urbane dhe rurale), kohëzgjatjen e shërbimeve të nevojshme (d.m.th., ditën e plotë, gjatë gjithë vitit), politikën për subvencionimin e kostove të EFH-së ose sigurimin e qasjes falas. Analizat gjinore gjithashtu duhet të vlerësojnë njohuritë për barazinë gjinore të rëndësishme për EFH, duke përfshirë politikëbërësit, anëtarët e komunitetit dhe ofruesit e shërbimeve EFH.
- Të angazhohen ekspertë për çështjet gjinore, trajnerë para dhe gjatë punës, anëtarë të komunitetit dhe palë të tjera të interesuara në nivel komunal dhe kombëtar në analizat dhe planifikimin e situatës.

¹³¹ MASHTI, *Strategjia e arsimit 2022-2026, Plani i veprimit*, 2022.

¹³² UNICEF, *Build to Last. A Framework in Support of Universal Quality Pre-primary Education* [Qëndrueshmëri afatgjate, një kornizë në mbështetje të arsimit parafillor cilësor dhe universal], 2020.

¹³³ UNICEF, *Tackling Gender Inequality from the Early Years* [Trajtimi i pabarazisë gjinore që në vitet e hershme], 2022.

- Të sigurohet buxheti dhe trajnimi i zyrtarëve publikë përkatës në nivel komunal dhe kombëtar (p.sh., DKA, anëtarët e komitetit të EFH MASHTI, Agjencia Kosovare e Akreditimit, pikat qendrore për çështje gjinore, ASK) në mbledhjen dhe analizën e të dhënave të përgjegjshme gjinore. Të angazhohen këta zyrtarë në të gjitha vlerësimet e situatës, analizat gjinore dhe grupet e punës lidhur me politikëbërjen.
- Të sigurohet trajnimi i zyrtarëve publikë përkatës në pedagogjinë e përgjegjshme gjinore (PPGJ) (p.sh., DKA, anëtarët e komitetit të EFH MASHTI dhe Inspektorati). Të angazhohen këta zyrtarë, si dhe ofruesit e shërbimeve të EFH (stafi dhe mësimdhënësit) dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës në grupet punuese që zhvillojnë kurrikulat dhe kornizat e SC dhe sistemet e monitorimit.
- Të bëhen përpjekjet që legjislacioni ta bëjë EFH të qasshme dhe me kosto të përballueshme për familjet me të ardhura më të ulëta dhe ato me vajza dhe djem që kanë nevoja të ndryshme mësimore. Të sigurohet që Ligji për EFH, Ligji për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës, Ligji për Arsimin, Ligji për Arsimin në Komunën e Republikës së Kosovës, Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Ligji për Tekstet Shkollore, UA për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve në Shkolla dhe UA për Financimin e Zhvillimit Profesional të Mësuesve u përgjigjen në mënyrë eksplicite situatave dhe nevojave të ndryshme ndërthurëse të vajzave dhe djemve të ndryshëm bazuar në analizën gjinore, duke integruar kriteret dhe detyra të qarta gjinore të përgjegjshme dhe transformuese për të gjithë aktorët. Legjislacioni për skemat sociale, subvencionet dhe investimet në shërbimet falas EFH mund të përmirësojnë koston.
- Të rritet financimi nga qeveria kombëtare dhe komunale për EFH, duke ndërtuar dhe zgjeruar objektet dhe kushtet për të rritur numrin e vajzave dhe djemve të ndryshëm të regjistruar në EFH, bazuar në vlerësimet e komuniteteve që kanë më shumë nevojë për shërbimet publike EFH. Investimet duhet të përfshijnë buxhetimin për objektet EFH që u përgjigjen situatave të ndryshme rajonale (urbane, rurale, nevoja për transport dhe orët e punës së kujdestarëve të grave dhe burrave), aftësitë fizike dhe njohëse të vajzave dhe djemve (p.sh., buxheti për asistentët e mësimdhënies, infrastruktura e vlerësuar dhe pajisjet ndihmëse), nevojat gjuhësore dhe ushqimore.
- Të përfshihet në mënyrë të qartë BPGj-ja në Strategjinë Arsimore dhe Planin e Veprimit, buxhetet vjetore të arsimit, si dhe politikat dhe legjislacioni i EFH dhe politikat e ndihmës sociale për të përmirësuar pabarazitë gjinore në nivel lokal dhe kombëtar. Politikat duhet të ndajnë buxhetin për zbatimin e BPGj (p.sh., politikat që rregullojnë arsimin para punës dhe mundësitë e zhvillimit profesional gjatë punës) dhe SC duke përdorur tregues të përgjegjshëm gjinor për vlerësimin e ndryshimeve në stereotipet gjinore dhe koordinimin ndër-institucional. Të përfshihen linjat të veçanta buxhetore që ndajnë fonde për trajnime përkatëse të përgjegjshme gjinore, strategjitë e sigurimit të cilësisë, skemat sociale, strategjitë e rekrutimit dhe aktivitetet e angazhimit të komunitetit. Të merret parasysh angazhimi i RrGK për të ofruar ekspertizë për të mbështetur BPGj-në.
- Të sigurohet buxheti në planet e veprimit për trajnime transformuese gjinore për të gjithë zyrtarët publikë përkatës, duke përfshirë: ngritjen e kapaciteteve për ndërgjegjësimin për legjislacionin dhe mekanizmat e barazisë gjinore, të drejtat e vajzave dhe djemve, normat diskriminuese gjinore, mekanizmat organizativë të përgjegjshëm gjinor, strategjitë e rekrutimit të përgjegjshme ndaj gjinisë, qasjet pedagogjike të përgjegjshme ndaj gjinisë, rishikimin gjinor të materialeve mësimore dhe të mësimdhënies dhe programet e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe prindërve për qasjet edukative dhe sociale transformuese gjinore.
- Në politikat të kërkohet që kurrikulat të përfshijnë përshkrime dhe shembuj për mësuesit dhe stafin e EFH se si të zbatojnë kurrikulat duke përdorur qasjen BPGj.
- Politikat duhet të përfshijnë tregues të përgjegjshëm gjinorë dhe ndërthurës për vlerësimin e zbatimit të kurrikulave, cilësisë së shërbimeve dhe përfituesve të shërbimeve.
- Të angazhohen ekspertë të çështjeve gjinore, duke përfshirë organizatat për të drejtat e grave, për të zhvilluar dhe ofruar trajnime për transformimin gjinor për zyrtarët publikë përkatës.

Kurrikula dhe zbatimi

- Të sigurohet që korniza e kurrikulës të përfshijë kritere ose standarde specifike (për mësuesit dhe menaxhmentin e institucioneve të EFH) për krijimin e mjediseve mësimore të përgjegjshme gjinore, në të cilat vajza dhe djem të ndryshëm ndihen të mirëpritur dhe rehat.
- Të sigurohet që kurrikulat janë transformuese gjinore dhe marrin parasysh paragjykimet gjinore dhe se si ato reflektohen në përmbajtjen e kurrikulës.
- Të zhvillohen rezultatet e të nxënësve bazuar në kompetencat zhvillimore të përshtatshme për moshën që janë transformuese gjinore. Përfshirja e rezultateve të të nxënësve transformues gjinor nuk siguron domosdoshmërisht që kurrikula të zbatohet duke përdorur GRP dhe duhet të shoqërohet me trajnimin e duhur të mësuesve në ofrimin e kurrikulave transformuese gjinore.
- Të përfshihen në kornizën e kurrikulës praktika specifike pedagogjike që mësuesit pritet të përdorin në klasë për të siguruar që ata zbatojnë qasje të përgjegjshme gjinore në zbatimin e kurrikulave. Korniza e kurrikulës EFH duhet të përfshijë udhëzime dhe përshkrime të shembujve të qasjeve të përgjegjshme dhe transformuese gjinore për ofruesit e shërbimeve EFH. Për shembull, korniza e kurrikulës duhet të përfshijë mjete dhe udhëzime se si të zbatohet një rishikim gjinor i materialeve mësimore (libra dhe lodra); të ofrojë udhëzime hap pas hapi se si të angazhohen vajzat dhe djemtë në aktivitete të përgjegjshme dhe transformuese gjinore që sfidojnë stereotipet gjinore të portretizuara në tregime dhe ilustrime; dhe të përfshijë sugjerime dhe shembuj të metodave të ndryshme mësimore për ta bërë përmbajtjen të përshtatshme për interesa dhe përvoja të ndryshme jetësore të vajzave dhe djemve. Udhëzimet mund të rekomandojnë materiale të caktuara mësimore neutrale ndaj aspektit gjinor për mësimin e bazuar në lojëra (p.sh., kukulla dhe lodra që nuk përforcojnë normat gjinore ose një shumëllojshmëri kukullash dhe lodrash për vajza dhe djem) dhe për rutinat e përditshme që ofrojnë qasje të barabartë për vajzat dhe djemtë në këndet e mësimin, koha e lojës në natyrë dhe pajisjet.
- Të përfshihen në kurrikula aktivitete mësimore të rekomanduara që janë të përgjegjshme gjinore dhe potencialisht transformuese. Për shembull, të përfshihen aktivitete opsionale për të siguruar që vajzat dhe djemtë mund të kenë qasje në të njëjtën përmbajtje në të njëjtin nivel, duke përdorur metoda të diferencuara të angazhimit. Të përfshihen shembuj aktiviteteve që luftojnë stereotipet gjinore rreth aktiviteteve se në të cilat aktivitete duhet të angazhohen vajzat ose djemtë. Të përfshihen aktivitete të sugjeruara që inkurajojnë vajzat dhe djemtë të punojnë së bashku.
- Të rishikohen materialet mësimore dhe tekstet shkollore për paragjykimet gjinore. Të ndahen mjete për mbledhjen, analizën dhe rishikimin e të dhënave.
- Të ketë bashkëpunim me kompanitë botuese për të siguruar që botuesit janë të vetëdijshëm për stereotipet diskriminuese gjinore dhe kanë kapacitetin për t'i trajtuar këto duke përdorur imazhet dhe gjuhën e përshtatshme në tekste.

Fuqia punëtore

- Të përfshihen kompetencat dhe standardet që i përgjigjen gjinisë për ofruesit dhe mësuesit e shërbimeve EFH. Politikat duhet të përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite standardet, treguesit e GRP dhe të parashikojnë dispozita për të mbështetur mësuesit në realizimin e tyre.
- Të përdoret BPGj për të ndarë buxhete specifike në legjislacion dhe politika për trajnimin e mësuesve transformues gjinor për të siguruar aftësinë e mësuesve për të zbatuar kurrikulat dhe për t'u ofruar vajzave dhe djemve mundësi për të mësuar dhe zhvilluar.
- Të përfshihen strategjitë e trajnimit të mësuesve bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnimin para shërbimit dhe zhvillimin profesional gjatë shërbimit. Këto duhet të rrisin ndërgjegjësimin për stereotipet diskriminuese gjinore; të përfshijnë strategji për reflektimin dhe vlerësimin e ndërgjegjësimin, qëndrimeve dhe njohurive individuale për GRP-në; të edukojnë se si përdorimi i gjuhës trajton stereotipet diskriminuese gjinore; dhe të këshillojnë se si të përdoren materialet mësimore (p.sh., libra, lodra, pajisje), duke siguruar qasje të barabartë në burime për vajzat dhe djemtë.

- Të zhvillohen strategji për përmirësimin e mjedisit të punës së institucioneve dhe profesioneve të EFH. Përveç përmirësimeve dhe investimeve infrastrukturore, të vendosen paga që lejojnë një standard të mirë jetese, të bëhen përpjekje për të profesionalizuar shërbimin, t'u sigurohet mësuesve koha e duhur për përgatitjen e mësimeve dhe trajnimeve, dhe të zbatohen politikat e sigurisë dhe shëndetit në punë specifike për institucionet EFH. Strategjitë mund të përfshijnë kërkesa alternative të kompetencave për mësuesit e angazhuar tashmë në ofrimin e EFH dhe strategji kombëtare për krijimin e shtigjeve të karrierës në sektorin EFH.
- Të zhvillohet një strategji për punësim që merr parasysh përgjegjësinë gjinore dhe synon të rrisë barazinë gjinore ndërmjet ofruesve dhe mësuesve të shërbimeve EFH. Kur burrat janë pjesë e fuqisë punëtore në EFH, angazhimi i tyre mund të sfidojë pikëpamjet tradicionale që e shohin gratë si kujdestare dhe të sigurojë që shkolla dhe mësimi të jenë neutrale gjinore. Masat për rekrutimin me përgjegjësi gjinore mund të përfshijnë: fushata komunikimi më të përshtatshme ndaj gjinisë; këshilla profesionale dhe karrierë; krijimin e rrjeteve dhe/ose sindikatave për EFH; shqyrtimin dhe rishikimin e kurrikulave dhe kulturës së trajnimit para shërbimit për t'i bërë ato më miqësore ndaj burrave; dhe përfshirjen e kërkesave akademike të forta.

Angazhimi i familjes dhe komunitetit

- Të zbatohen fushata ndërgjegjësimi mbi përfitimet e EFH-së që synojnë dhe arrijnë gratë dhe burrat kujdestarë nga rajone të ndryshme, etni të ndryshme, situata socio-ekonomike dhe fusha të ndryshme arsimore.
- Të vendosen standarde institucionale të EFH-së që angazhojnë kujdestarët gra dhe burra në mënyrë të barabartë. Për shembull, kur fëmija është i sëmurë, shkolla duhet të kontaktojë të dy kujdestarët. Kjo mund të përfshijë gjithashtu mbështetje për edukatorët dhe stafin tjetër për të ftuar dhe përfshirë kujdestarët burra në aktivitetet për prindërit, duke bërë hapësirat më mikpritëse për kujdestarët burra dhe organizimin e seancave të veçanta për kujdestarët burra dhe gra.
- Të ofrohen mundësi trajnimi për stafin dhe mësuesit e EFH mbi strategjitë dhe përfitimet e angazhimit të barabartë të kujdestarëve të grave dhe burrave në edukimin dhe kujdesin e hershëm të fëmijëve.

Sigurimi i cilësisë

- Të zhvillohen, planifikohen dhe buxhetohen strategjitë dhe praktiket e sigurimit të cilësisë në nivel kombëtar, komunal dhe parashkollor, duke përdorur mjete inspektimi dhe formularë vetëvlerësimi që pyesin në mënyrë eksplicite nëse parashkollorët adresojnë stereotipet gjinore. Të përfshihen ekspertë gjinorë në të gjitha fazat e sigurimit të cilësisë dhe të angazhohen komuniteti dhe palët e tjera të interesuara në konsultime dhe ndarje të gjetjeve.
- Të sigurohet që politikëbërësit, ekspertët në çështjet gjinore dhe palët e interesuara të përdorin këto gjetje për të informuar rishikimet e politikave ekzistuese, politikave të reja dhe buxhetimin nga perspektiva gjinore.
- Të ndërmerren rishikime gjinore të legjislacionit dhe politikave ekzistuese për të siguruar që barrierat e ndryshme janë kapërcyer në përputhje me legjislacionin dhe specifikimet dhe standardet e politikave. Të angazhohen ekspertë në çështjet gjinore, duke përfshirë organizatat për të drejtat e grave dhe palët e interesuara.
- Të caktohen fonde të mjaftueshme për zbatimin e strategjive të sigurimit të cilësisë.
- Të zbatohen strategji dhe procese monitorimi për sigurimin e standardeve të cilësisë së objekteve, shërbimeve, operacioneve organizative parashkollore, kompetencave të stafit dhe mësuesve dhe mjediseve mësimore (p.sh., materialet mësimore dhe praktiket pedagogjike të mësuesve). Për vëzhgimet institucionale dhe në klasë, RrGK mund të mbështesë me mjete dhe shabllone për vlerësimin e qasjeve të përgjegjshme dhe transformuese gjinore të zbatuara në institucionet EFH dhe mjediset mësimore.
- Të trajnohen inspektorët përkatës të sigurimit të cilësisë, zyrtarët e DKA-së dhe zyrtarët e MASHTI-t mbi përdorimin e mjeteve dhe shablloneve për vlerësimin e sistemeve organizative dhe qasjeve pedagogjike transformuese dhe të përgjegjshme gjinore të mësuesve dhe stafit në EFH.

- Të përfshihen tregues specifikë të përgjegjshëm gjinore në kriteret e vlerësimit. Të përfshihen tregues të nivelit të procesit dhe të ndarë sipas gjinisë. Treguesit duhet të ndahen sipas gjinisë në të gjitha situatat dhe nevojat e ndryshme ndërthurëse. Të përfshihen tregues të paragjykitimit gjinor që vlerësojnë shkallën që mësuesit u ofrojnë vajzave dhe djemve mundësi të barabarta për të marrë pjesë në klasë; kanë pritshmëri të ngjashme për vajzat dhe djemtë; shfaqin paragjykim (d.m.th., në gjuhë dhe/ose qëndrim); dhe sfidojnë stereotipet në klasë. RrGK mund të mbështesë institucionet në këtë vlerësim me tregues dhe modele për vlerësimin e këtyre kriterëve.
- Të sigurohet që strategjia e sigurimit të cilësisë përshkruan në mënyrë eksplicite procedurën për të integruar gjetjet në planifikim, duke përfshirë çdo rihartim për t'iu përgjigjur pabarazive dhe pabarazive gjinore. Këto gjetje mund të kontribuojnë në përditësimin e analizave gjinore që informojnë për përmirësimet.


Burimet e cituara

- Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 Plani i Veprimit](#), 2020.
- _____, [Parandalimi i stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore udhëzues metodologjik](#), n.d.
- Aliu-Gashi, Mevlude, Zehrie Plakolli, et. al., [Cidree Yearbook 2022. Challenges facing the organisation and realisation of pre-school education in Kosovo](#)[Sfidat me të cilat përballet organizimi dhe realizimi i arsimit parashkollor në Kosovë], 2022.
- Aliu-Gashi, M., et al., KPI, [Edukimin parashkollor në Kosovë - Arritjet dhe sfidat në Kërkime Pedagogjike](#), 2021.
- Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) [Problemet dhe të meta e teksteve shkollore: Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët \(Klasa VI, VII, VIII dhe IX\)](#), 2013.
- Behluli, Vigan, [Mapping of Early Childhood Development Services in Kosovo](#), 2020.
- Komisioni Evropian (KE), [Barcelona Objectives: The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth](#). [Objektivat e Barcelonës: Zhvillimi i objekteve të kujdesit ndaj fëmijëve për fëmijët e vegjël në Evropë, me synimin e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse], 2013.
- Këshilli i Bashkimit Evropian, [Council Recommendation on early childhood education and care: Barcelona targets for 2030](#) [Rekomandimi i Këshillit mbi Edukimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme: Objektivat e Barcelonës për vitin 2030], 2022.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ["Agjencia e Statistikave të Kosovës"](#), qasur më 15 prill 2024.
- _____, ["Të dhënat e ASK: Anketa e Fuqisë Punëtore"](#), 2022, qasur më 15 prill 2024.
- _____, ["Të dhënat e ASK: Papunësia dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grupmoshës, 2012-2022"](#), 2022, qasur më 15 prill 2024.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), [Auditim të Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor](#), Prishtinë, 2007.
- Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), [Barazia gjinore në tekstet shkollore gjatë nëntë viteve të arsimit të detyrueshëm në Kosovë](#), 2007.
- Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), [Nën hije, analiza gjinore e punës joformale në Kosovë](#), 2024.
- _____, [Analiza gjinore e Kosovës](#), 2018.
- _____, [Kush kujdeset?](#), 2016.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), [Raport Vjetor Statistikor me Tregues Arsimorë 2021-2022](#), 2022.
- _____, [Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës \(e rishikuar\)](#), 2016.
- _____, [Standardet për zhvillim dhe mësim të hershëm për fëmijët e moshës 0-6 vjeç](#), tetor 2011.
- _____, [Statistikat e Arsimit në Kosovë](#), 2023.
- _____, [Strategjia e arsimit 2022-2026](#), 2022.
- _____, [Strategjia e arsimit 2022-2026 Plani i veprimit](#), 2022.
- _____, [Udhëzime për normat dhe standardet për hapësirat e objekteve parashkollore](#), 2018.
- _____, [Lista shkollave të licencuara parashkollore dhe parafillore](#), qasur 15 prill 2024.
- _____, ["MASHTI ka filluar trajnimin e trajnerëve për pilotimin e kurrikulës për EFH"](#), 8 dhjetor, 2023.
- _____, faqe e internetit, [Doracak për mësimdhënësit, ndër-kulturalizmi në arsim](#), 2023.
- _____, faqe e internetit, ["Ministrja Nagavci mori pjesë në dëgjimin publik të projektligjit për tekstet shkollore"](#), 27 mars 2024.
- _____, [Subject Curricula/Syllabuses, Preparatory Grade](#), 2018.
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), [Starting Strong 2017: Key OECD Indicators on Early Childhood Education and Care](#) [Fillim i fuqishëm: Treguesit Kryesorë të OBZHE mbi Edukimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme], OECD Publishing, Paris, 2017.
- Kombet e Bashkuara (OKB), [Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women](#)[Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave], 1981.
- _____, [Convention on the Rights of the Child](#), [Konventa për të Drejtat e Fëmijës]. 1989.
- _____, faqe e internetit, [Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), 2015.
- UNESCO, [Education Starts Early](#)[Edukimi fillon herët], 2022.
- United Nations Girls Education Initiative, [Spending Better for Gender Equality in Education](#), 2021. Iniciativa e Kombeve të Bashkuara për Edukimin e Vajzave, [Spending Better for Gender Equality in Education](#) [Përdorim më efektiv i buxhetit për barazi gjinore në arsim], 2021

- United Nations International Children's Emergency Fund (UNICEF), [Build to Last. A Framework in Support of Universal Quality Pre-primary Education](#) [Qëndrueshmëri afatgjate, një kornizë në mbështetje të arsimit parafillor cilësor dhe universal], 2020.
- _____, [ECE Accelerator Toolkit](#), 2020.
- _____, [State of Children's Rights Kosovo](#) [Gjendja e të Drejtave të Fëmijës në Kosovë] 2021.
- _____, [Tackling Gender Inequality From the Early Years. Strategies for Building a Gender Transformative Pre-primary Education System](#) [Trajtimi i pabarazisë gjinore që nga vitet e hershme, Strategjitë për ndërtimin e një sistemi arsimor parafillor transformues gjinor], 2022
- UNICEF Zyra e UNICEF-it në Kosovë, [Country Office Annual Report 2023](#) [Raporti vjetor 2023].
- Republika e Kosovës, [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#), 15 qershor 2008.
- _____, Kuvendi, Ligji nr. 03/L-068 për [Arsimin në Komunitet dhe Republikën e Kosovës](#), 21 maj 2008.
- _____, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore](#), 2015.
- _____, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#), 2015.
- _____, Kuvendi, Ligji nr. 05/L-066 për [Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës](#), 21 nëntor 2016.
- _____, Kuvendi, Ligji nr. 06/L-046 për [Inspektorati e Arsimit në Republikën e Kosovës](#), 10 gusht 2018.
- _____, Kuvendi, [Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve](#), 17 korrik 2019.
- _____, Kuvendi, Ligji nr. 08/L-153 për [Edukimin në Fëmijërinë e Hershme](#), 3 gusht 2023.
- _____, Qeveria, Udhëzimi Administrativ (GRK) nr. 06/2022 Establishment and Functioning of the [Team on the Protection of the Child](#), 2022.
- _____, Qeveria, Udhëzimi Administrativ (GRK) nr. 07/2022 për [Autoritetet për të Drejtat e Fëmijës](#), 2022.
- _____, Qeveria, Udhëzimi Administrativ (GRK) nr. 08/2022 për [Këshillin për të Drejtat e Fëmijës](#), 2022.
- _____, Qeveria, [Qeverisja Lokale në Kosovë dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), n.d.
- _____, Qeveria, Rregullore (GRK) nr. 03/2017 për [Mekanizmat Institucional për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna](#), 2017.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për [Mjetet e dedikuara për financimin e edukimit parashkollor publik dhe mënyrat e shpenzimit të tyre](#), 2008.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 03/2022 për [përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë](#), 2022.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 06/2011 [Licencimi dhe Regjistrimi i Institucioneve Arsimore Parashkollore Private](#), 2011.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 15/2013 për [Financimin e Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve](#), 2013.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ (GRK) nr. 40/2007 për [Mbiqyrtjen Profesionale Pedagogjike të Punës së Edukatorëve dhe Bashkëpunëtorëve Profesional](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 41/2007 [Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 42/2007 [Kushtet dhe mundësitë për mbështetjen e arsimit parashkollor sipas komuniteteve](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 43/2007 për [përcaktimin e procedurës, rasteve dhe afateve të ndërprerjes së punës në institucionet parashkollore](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 44/2007 për [Kohëzgjatjen e programeve parashkollore](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 45/2007 për [Publikimin e Organizimit të Arsimit në Institucionet Parashkollore](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 46/2007 për [Mënyrën e zgjedhjes së programeve parashkollore nga prindërit e fëmijëve](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 47/2007 për [fondin javor i orëve për edukatorë](#), 2007.
- _____, Qeveria, MASHTI, Udhëzimi Administrativ nr. 119/2020 për [zhvillimin profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë](#), 2020.
- _____, Qeveria, MASHTI, Vendimi nr. 01B/347 [Komisioni për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme](#), 3 dhjetor 2021.
- Banka Botërore, [Teach EFH: Helping Countries Track and Improve Teaching Quality in Early Childhood Education](#) [Mësoni EFH: Ndhimë vendeve në gjetjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin e hershëm], 2021.
- VVOB dhe FAWE, [Gender-Responsive Pedagogy in Early Childhood Education a Toolkit for Teachers and School Leader](#), VVOB, Bruksel, 2019. [Pedagogjia e përgjegjshme gjinore në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme: Udhëzues për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave]

Anekset

Grafiku 1. Numri i institucioneve publike dhe private të arsimit të hershëm dhe parashkollor (sipas komunës)



Grafiku 2. Regjistrimi në institucionet publike dhe private të arsimit të hershëm në vitin 2022/23 (sipas gjinisë)






Tabela 1. Vajzat dhe djemtë që ndjekin arsimin e hershëm (0-6) në Kosovë (sipas përkatësisë etnike)

Përkatësia etnike	Parashkollor (0-4 vjeç)	Parafillor (5-6 vjeç)	Gjithsej
Shqiptar	5330	18152	23482
Serb	35	41	76
Turk	22	223	245
Boshnjak	14	119	133
Goran	0	29	29
Ashkali	3	221	224
Rom	14	73	87
Egjiptian	2	84	86
Kroat	0	4	4
Gjithsej	5420	18946	24366


Grafiku 3. Fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin institucionet publike të arsimit të hershëm (0-6)



Grafiku 4. Vajzat dhe djemtë që ndjekin qendrat burimore të arsimit të hershëm



Grafiku 5. Statusi social dhe familjar i vajzave dhe djemve që ndjekin arsimin e hershëm dhe parashkollor (0-6)



Grafiku 6. Punonjësit që punojnë në institucionet publike parashkollore (0-4) sipas gjinisë

